



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 50 regjistër (JR)
Datë 05.12.2022

Nr. 46 i vendimit
Datë 02.11.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 02.11.2023, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 50/2022 (JR), datë 05.12.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 560, datë 14.09.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe 179/b, pika 5 Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; neni 442 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 560, datë 14.09.2022, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1; 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet ndihmëse përkatëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, ka dërguar në Komision një raport në të cilin, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
 - 3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar raportin e parë, nr. {***}, datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 26.07.2022, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar, ku është evidentuar

se formulari për kontrollin e figurës është plotësuar saktësisht nga subjekti dhe ai është vlerësuar i përshtatshëm për ushtrimin e detyrës. Në vijim, me raportin e datës 21.06.2021, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 24.06.2021, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, bazuar në disa informacione konfidenciale të organeve ligjzbatuese.

3.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 560, datë 14.09.2022.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 560, datë 14.09.2022, lidhur me të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Julian Xhengo:
 - i. referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016;
 - ii. nga vlerësimi tërësor i rrethanave, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, janë vërtetuar fakte dhe rrethana që tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
6. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, bazuar në nenin 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin e Komisionit

7. Subjekti i rivlerësimit në datën 18.11.2022, ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 560, datë 14.09.2022. Në konkluzion të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj tij; (iii) ndryshimin e vendimit nr. 560, datë 14.09.2022, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Këto kërkime janë përsëritur nga subjekti i rivlerësimit edhe në parashtrimet me shkrim të datës 24.10.2023, të paraqitura përpara seancës.

8. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit mbi procesin e rregullt dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë.

8.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së për një proces të rregullt ligjor, pasi Komisioni në shqyrtimin e çështjes së tij, ka shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Komisioni, sipas parashikimeve të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, para se t'i jepte mundësinë për t'u dëgjuar, duhet t'i bënte prezent, përveç rezultateve të hetimit, edhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative.

8.2. Komisioni nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me gjetjet dhe konstatimet në lidhje me vlerësimin e kriterit të figurës dhe atij profesional, por ka kërkuar sqarime me shprehjen standarde: *Subjekti të japë sqarime për konstatimin/konstatimet e mësipërme, duke e shoqëruar me dokumentacion.*

8.3. Komisioni ka bërë vlerësim të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara e të vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterëve të pasurisë, figurës dhe profesionalizmit, pasi nuk ka analizuar dhe nuk ka marrë në vlerësim të gjitha provat e administruara gjatë hetimit administrativ, ka cituar në mënyrë të pjesshme një pjesë të këtyre provave apo i ka keqinterpretuar ato.

8.4. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së armëve pasi në disa vendime të tjera të Komisionit, pavarësisht se janë konstatuar shkelje të rënda procedurale dhe mangësi profesionale, subjektet e rivlerësimit janë kualifikuar të përshtatshëm profesionalisht.

8.5. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, subjekti i rivlerësimit parashtron se shkarkimi sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i mundur të bëhet duke u bazuar vetëm në një apo në dy nga kriteret, për arsye se kërkohet të ketë një cenim në një nivel të besueshëm të të tria kriterëve së bashku për të vlerësuar pamundësinë e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë të subjektit për cenim të besimit të publikut.

8.6. Subjekti në ankim, referuar nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, kërkon nga Kolegji që shqyrtimi i çështjes të bëhet në seancë gjyqësore me praninë e palëve pasi debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar pretendimet e tij se vendimi i Komisionit është bazuar në shkelje të rënda procedurale dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë prej tij.

9. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit, ka parashtruar se:

9.1. Për automjetin “Mercedes-Benz”, tipi “220 CDI”, blerë në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

9.1.1. Është i pabazuar dhe në kundërshtim me të gjitha provat e administruara konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri ka dhënë deklarime të pasakta dhe kontradiktore për të fshehur vlerën reale të paguar për blerjen e automjetit. Subjekti nuk arrin të identifikojë në vendimin e Komisionit çfarë deklarimi të pasaktë dhe aq më tepër kontradiktor ka bërë në lidhje me rrethanat e blerjes së këtij automjeti. Nga shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij në kuadër të barrë së provës, janë sqaruar rrethanat e blerjes së automjetit dhe nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se pretendimet dhe argumentet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe janë të pabazuara.

9.1.2. Për sa i përket propozimit për shitjen e automjetit, data e pasqyruar si datë propozimi në kontratën e shitblerjes, është gabim material i noterit. Nuk ka asnjë të dhënë, indicie apo provë si mund të ketë marrë dijeni subjekti i rivlerësimit për propozimin për shitjen e këtij automjeti, pasi një fakt i tillë thjesht nuk ka ndodhur.

9.1.3. Nga provat e paraqitura, rezulton se vlera reale e blerjes së automjetit është 980.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 26.12.2016, dhe është i pabazuar qëndrimi i Komisionit që në analizën financiare të vitit 2016, ka përfshirë si vlerë/shpenzim çmimin e blerjes së automjetit në Itali prej 9.500 eurosh, si dhe detyrimin doganor prej 494.809 lekësh, në total vlerën 1.779.874 lekë. Vendimmarrja e Komisionit në analizën financiare të vitit 2016, lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, duket se kërkon të përlligjë artificialisht dhe në mënyrë të sforcuar krijimin e një balance negative.

9.1.4. Komisioni, në lidhje me kontratën e shitblerjes, përdor dy standarde arsytimi, pasi në rastin e propozimit për shitje, shprehet se kontrata është një akt shkresor me fuqi të plotë provuese që vërteton se palët kanë qenë në një marrëveshje/marrëdhënie të përbashkët, ndërsa në rastin e çmimit të dakordësuar midis palëve në kontratë, Komisioni argumenton se çmimi i kontratës nuk është i saktë, duke rrëzuar fuqinë provuese të aktit shkresor.

9.2. Për pasurinë shtëpi banimi 1-katëshe, me sip. 120 m², Tiranë, e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

9.2.1. Lidhur me mosdeklarimin e prindërve si persona të lidhur, subjekti pretendon se për sa kohë ka jetuar nga emërimi në detyrë dhe në vazhdim në një ekonomi tërësisht të ndarë nga prindërit, ndarja nga certifikata familjare është një akt formal dhe pa pasoja për të si subjekt rivlerësimi. Subjekti kërkon nga Kolegji që nëse në përfundim do të vlerësojë se prindërit e tij janë persona të lidhur, duke pasur parasysh paqartësinë që ka ekzistuar mbi këtë detyrim në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, si dhe faktin se nga hetimi administrativ në Komision nuk ka rezultuar se prindërit kanë pasuri të pajustificuara ligjërisht, në vlerësim të parimit të

proporcionalitetit, kjo të konsiderohet një pasaktësi formale që nuk ndikon në marrjen e vendimit përfundimtar.

9.2.2. Subjekti kundërshton vlerën përfundimtare të ndërtimit prej 5.040.663 lekësh, të konkluduar nga Komisioni, dhe kërkon në Kolegj uljen e kësaj vlere pasi TVSh-ja e pagueshme dhe pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në kushtet kur banesa është ndërtim informal i kryer nga familjarë dhe të njohur, janë rreth 8% e kostos së ndërtimit pa TVSh.

9.3. Lidhur me konkluzionet e Komisionit për konstatimet e tjera, lidhur me banesën me qira ku ka jetuar në periudhën janar 2016 - janar 2017, subjekti i rivlerësimit pretendon:

9.3.1. Kontrata e qirasë me shtetasen I. B. është lidhur verbalisht, për shkak se afati i kësaj kontrate nuk ka qenë mbi një vit që të kërkohej formë shkresore sipas nenit 803, paragrafi i katërt i Kodit Civil.

9.3.2. Detyrimi tatimor për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, është detyrim i qiradhënësës e cila nuk e ka përmbushur këtë detyrim, dhe për të mos deklaruar të ardhurat dhe për të paguar detyrimin tatimor me vonesë, ka refuzuar kërkesën e bashkëshortes së subjektit për lëshimin e një deklaratë noteriale që do të konfirmonte qëndrimin në apartamentin me qira.

9.4. Lidhur me analizën financiare të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendon:

9.4.1. Balanca negative e vitit 2010, prej -108.899 lekësh, vjen për shkak se Komisioni nuk ka njohur gjendjen në *cash* 6.000 euro, aq sa ka qenë vlera reale e shitjes së automjetit tip “Wolkswagen Golf”, por ka njohur vetëm vlerën prej 530.000 lekësh, sa ka qenë vlera e blerjes së këtij automjeti.

9.4.2. Balanca negative e vitit 2016, prej -626.453 lekësh, vjen si rezultat vetëm i njohjes së blerjes së automjetit në shumën 1.779.874 lekë, dhe jo aq sa është deklaruar me vullnet të lirë midis palëve, në shumën 980.000 lekë, për të cilën ka dhënë argumente shteruese se çmimi real i blerjes së automjetit ka qenë aq sa është deklaruar në kontratën e nënshkruar midis palëve, e me konsiderimin e çmimit të blerjes së automjetit aq sa është në kontratë, prej 980.000 lekësh, analiza negative e vitit do të korrigjohet në pozitive.

10. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ankimon në Kolegj se nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me kriterin e figurës. Subjekti pretendon se në rezultatet e hetimit dhe në seancën dëgjimore nuk i është kërkuar ndonjë sqarim për informacionet në lidhje me çështjen penale që i takon shoqërisë “{***}” ShPK, duke referuar paragrafin 83.3 të vendimit të Komisionit. Subjekti parashtron se nuk është i qartë se cilat informacione konfidenciale ka pasur Komisioni dhe për çfarë veprimtarie të kundërligjshme bëhet fjalë, dhe përmendja në vendim e tyre është bërë në funksion të arritjes së një konkluzioni të sforcuar për ekzistencën e elementeve që cenojnë besimin e publikut. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit vlerëson të papabazura konstatimet

e Komisionit se deklarimet e tij për pronësinë e mjetit me targë {***}, mbeten të dyshimta dhe duket se janë bërë me qëllim për të fshehur faktin që mjete ka qenë në pronësi të shtetasit S. Sh..

11. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës për asnjë nga çështjet që i përkasin këtij kriteri, në bazë të përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana e Komisionit, në rezultatet e hetimit administrativ, i është kërkuar të japë sqarime për 15 çështje të hetuara prej subjektit, nga të cilat në vendimin përfundimtar ka konstatuar problematika për 10 prej tyre. Lidhur me konstatimet e Komisionit për këto 10 çështje, subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij prapëson si vijon:

11.1. Për procedimin penal nr. {***}, datë 29.05.2014, me të pandehur shtetasin A. G., është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se zgjatja e afatit të hetimeve vetëm për njohjen e të pandehurit me aktet nuk është objektivisht e justifikueshme. Subjekti parashtron se ka sqaruar në Komision se si shkak për zgjatjen e afatit të hetimeve me tre muaj, ka qenë së pari, ngarkesa në punë dhe së dyti, fakti që i pandehuri nuk ka dhënë një adresë të saktë për njoftimin e tij për kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse.

11.2. Për procedimin penal/praktikën nr. {***}, me kallëzuese shtetasen V. Q., është i pabazuar konstatimi i Komisionit për mosrespektimin e afatit 30-ditor të regjistrimit të procedimit penal, të përcaktuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm. Subjekti parashtron se si shkak për vonesën ka qenë ngarkesa në punë, për të cilën ka dhënë argumente në prapësimet përfundimtare dhe në seancë dëgjimore, por ky argumentim nuk rezulton të jetë përfshirë në vendimin e Komisionit.

11.3. Për ankesat e paraqitura nga shtetasi B. K., konstatimet e Komisionit janë të pabazuara pasi nuk ka mbajtur në konsideratë natyrën e çështjes, volumin e dokumentacionit të administruar, si dhe faktin që në përfundim të hetimeve, është vendosur dërgimi për gjykim i 15 të pandehurve dhe se kryerja e veprimeve procedurale për secilin prej tyre ka kërkuar kohën e nevojshme.

11.4. Lidhur me denoncimin e shtetasit H. Sh., subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka pasur zvarritje për shkak të regjistrimit penal tej afatit, si dhe ka vendosur pushimin e hetimit pa kryer hetime të plota, pasi, sipas tij, pushimi i hetimeve për procedimin penal nr. {***}, është vendosur bazuar në nenin 328, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale pasi për të njëjtin fakt, ishte regjistruar një procedim penal tjetër (nr. {***}) dhe çështja ishte dërguar për gjykim.

11.5. Për denoncimin e paraqitur nga shtetasi M. P., subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se janë marrë dy vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve pa i arsyetuar ato. Sipas subjektit, këto vendime janë marrë në kushtet e mbingarkesës në punë dhe gjykata nuk ka konstatuar ndonjë pavlefshmëri të zgjatjes së afatit të hetimeve, duke vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit M. P..

11.6. Lidhur me denoncimin e paraqitur nga shtetasi A. Ç., subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se nuk është dokumentuar marrja dijeni nga i pandehuri për kërkesën për gjykim, duke

prapësuar se të pandehurit i është njoftuar akuza dhe është njohur me të drejtat e tij në cilësinë e personit të pandehur kundrejt nënshkrimit, si dhe me të drejtën për të zgjedhur vetë dy mbrojtës apo për të kërkuar një të tillë nga organi procedues.

11.7. Për denoncimin e paraqitur nga shtetasi K. G., subjekti raporton se Komisioni u është referuar akteve të kërkesës për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, ndërkohë që me vendimin e datës 27.04.2021, është vendosur ndarja e kësaj çështjeje penale në dy procedime penale. Subjekti raporton se janë të pabazuara konkluzionet e Komisionit se ai nuk ka bërë përpjekje për të vërtetuar se veprimet hetimore përbëjnë sekret hetimor dhe se pohimet e tij mbeten në nivel deklarativ. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit informacion të reduktuar vetëm në datat e procesverbaleve të pyetjes së disa personave dhe inicialet e shtetasve të pyetur, si dhe ka sqaruar se janë dërguar shkresat dhe janë administruar përgjigjet dhe një sasi e konsiderueshme dokumentacioni nga institucione të ndryshme.

11.8. Për denoncimin e shtetasit Q. B., subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara konkluzionet e Komisionit pasi çështje të kësaj natyre, në të cilat ka pretendime për veprimtarinë e funksionarëve shtetërorë apo çështje të natyrës së krimit ekonomik e shtetëror nuk mund të trajtohen dhe analizohen thjesht në mënyrë mekanike, për vetë specifikën e tyre. Subjekti parashtron se hetimet prej tij janë kryer të plota, duke administruar gjithë dokumentacionin, duke marrë informacion nga organet e administratës shtetërore dhe duke kryer ekspertimin përkatës. Vendimi për pushimin e hetimeve i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe është lënë në fuqi nga gjykata.

11.9. Për denoncimin e paraqitur nga shtetasi E. L., subjekti parashtron në ankim se vendimi për mosfillimin e hetimeve është marrë tej afatit 15-ditor të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të mbingarkesës në punë. Subjekti raporton se nuk qëndron konstatimi i Komisionit se është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin e akteve, pasi ai ka përpiluar shkresën përcjellëse për njoftimin e vendimit dhe procedura e mëtejshme e njoftimit është procedurë administrative dhe e shërbimit postar.

11.10. Për denoncimin e paraqitur nga shtetasja D. Xh., subjekti i rivlerësimit parashtron se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se nga prokuroria nuk është verifikuar çdo pretendim i ngritur nga kallëzuesja në kallëzimin penal, pasi objekt i kallëzimit penal të paraqitur nga kjo shtetase, kanë qenë pretendime mbi veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore gjatë hetimit të rrethanave ku ka humbur jetën bashkëshorti i kallëzueses. Në fazën e verifikimit të pretendimeve të ngritura në një kallëzim penal, nuk ka hetim, por prokurori vendos regjistrimin e procedimit penal apo mosfillimin e hetimeve pasi vlerëson pretendimet e ngritura dhe nëse çmon se duhet bërë ndonjë verifikim për këto pretendime. Subjekti gjithashtu kundërshton se nuk qëndron konstatimi i Komisionit se është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin e akteve, pasi procedura e njoftimit është procedurë administrative dhe e shërbimit postar.

12. Bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktet: (i) shkresën e datës 14.11.2022, të noterit I. Sh. H.; (ii) historikun e lejes së qarkullimit për automjetin me targë {***}. Ndërsa, së

bashku me parashtrimet e paraqitura në Kolegj në datën 24.10.2023, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe ka kërkuar të merren në cilësinë e provës aktet: (i) raport mjekësor për shtetasin E. Xh., i datës 02.03.2023; (ii) kërkesë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kopje të vendimeve gjyqësore të dhëna nga kjo gjykatë, me objekt: “Caktim, ndryshim apo shuarje të masave të sigurimit personal”, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar prokurorinë pranë kësaj gjykate¹.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

13. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimimin e ankuesit

14. Ankuesi Julian Xhengo, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
15. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo, është shpallur në seancë publike më datë 14.09.2022. Vendimi i arsyetuar nr. 560, datë 14.09.2022, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 26.10.2022, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 03.11.2022. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 18.11.2022, pranë Komisionit, ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 560, datë 14.09.2022, protokolluar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 18.11.2022. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh

¹ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të 16 vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga të cilat rezulton se në datat 19.06.2015; 20.06.2015; 28.02.2016; 29.02.2016; 25.04.2016; 26.04.2016; 06.06.2016; 27.06.2016; dhe 28.06.2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë prezent si përfaqësues i organit të prokurorisë në seanca gjyqësore me objekt: “Caktim, ndryshim apo shuarje të masave të sigurimit personal dhe /ose caktime të masave të sigurimit për nevoja të ekstradimit” ndaj disa shtetasve.

nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) *Mbi formën e gjyqimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 566, datë 28.09.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
17. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
18. Trupi gjykues, referuar nenit 47² të ligjit nr. 49/2012, shqyrtoi dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve para seancës për t’u marrë në cilësinë e provës. Nga shqyrtimi i këtyre akteve të reja, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi që pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë ato gjatë hetimit administrativ në Komision. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me vlerën provuese të tyre, konkludoi se sipas nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, ato nuk janë të nevojshme pasi nuk përmbajnë ndonjë të dhënë apo fakt që do të ndikonte në shqyrtimin e ankimit.

B. Vlerësimi i pretendimeve të subjektit mbi aspektet procedurale dhe procesin e rregullt të zhvilluar në Komision

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, për një proces të rregullt ligjor, pasi Komisioni në shqyrtimin e çështjes së tij, ka shkelur parimin e

² “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Komisioni, sipas parashikimeve të nenit 87³ të Kodit të Procedurave Administrative, para se t'i jepte mundësinë për t'u dëgjuar, duhet t'i bënte prezent subjektit të rivlerësimit, përveç rezultateve të hetimit, edhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative që do të thotë praktikisht t'i bënte me dije se cila ishte situata e gjetjeve të Komisionit që mund të shkaktonte marrjen e masës disiplinore ndaj tij, ose e thënë ndryshe t'i kalonte barrën e provës. Sipas subjektit, në rezultatet e hetimit administrativ duhet të pasqyrohej qartë se cila shkelje, e parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, dyshohej të ishte kryer prej tij. Baza ligjore e shkeljes së pretenduar duhet të ishte përcaktuar qartësisht nga Komisioni në njoftimin dërguar subjektit për rezultatet e hetimit paraprak. Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t'u mbrojtur e dëgjuar efektivisht.

19.1. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas verifikimit të akteve dhe procedurave të zhvilluara në Komision, konstaton se subjektit i është vënë në dispozicion e gjithë dosja hetimore e krijuar në Komision, si dhe i është lënë një afat i arsyeshëm për paraqitjen e shpjegimeve, prapësimeve dhe provave. Në veçanti, nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentit “Raport mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ” për subjektin e rivlerësimit, evidentohet se për secilin kriter, Komisioni, në rubrikën “Hetimi i Komisionit”, ka evidentuar veprimet konkrete hetimore dhe ka cituar aktet e administruara, të cilat i janë nënshtruar analizës dhe në përfundim kanë çuar Komisionin në konkluzionet përkatëse, duke dhënë për çdo gjetje konstatimet e faktit dhe aktet mbi të cilat janë bazuar. Për çdo gjetje, subjekti është orientuar nga Komisioni që ka barrën e provës për të provuar të kundërtën. Trupi gjykues vëren se Komisioni, në kuptim e zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, ka realizuar detyrimin e tij si organ administrativ, duke garantuar të drejtën e subjektit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, si dhe për të paraqitur prova dhe argumente lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ. Subjekti është njoftuar nëpërmjet komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, për të cilat ai duhet të jepte shpjegime apo të sillte prova, duke i kaluar formalisht barra e provës, në kuptim e zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2006. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 09.09.2022, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në këtë seancë, ka dhënë vlerësimin e tij për rezultatet e hetimit paraprak, si dhe ka paraqitur argumentet dhe provat duke ezauruar çdo mundësi të parashikuar nga ligji që i garanton të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe

³ Neni 87, “Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”, parashikon: “1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64 i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm”.

mbrojtur. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson si të pabazuar pretendimin e subjektit për shkelje të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

19.2. Trupi gjykues vëren se nuk qëndron dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet t'i kishte bërë me dije se cilat shkelje të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, dyshohej të ishin kryer prej tij. Dispozitat kushtetuese dhe ligji nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë se si kryhet procesi i rivlerësimit, kriteret për të cilat bëhet ky proces, aktet mbi të cilat bazohet, si dhe mënyrën e deklarimit dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Kuadri ligjor për procesin e rivlerësimit ka të përcaktuar qartë rastet kur mospërbushja e detyrimeve nga subjektet apo pasaktësitë, deklarimet e pamjaftueshme apo jo me vërtetësi të interesave pasurorë dhe të të dhënave për kontrollin e figurës, përbëjnë shkaqe për dhënien e masave disiplinore, të cilat gjithashtu janë të parashikuara qartë për çdo shkelje. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit nuk kishte pse të kishte pritshmëri që Komisioni ta orientonte apo përcaktonte se cilat ishin shkeljet e mundshme që ai mund të kishte kryer, pasi si një magjistrat, ai vetë duhet të ishte i vetëdijshëm për rezultatet apo pasojat që do të vinin në kuadër të deklarimeve të tij dhe verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni, apo në rast mungese të shpjegimeve apo paraqitjes së provave, që mund të passillnin vendosjen e një mase disiplinore. Për më tepër, parapërcaktimi nga Komisioni i një baze ligjore për shkelje të mundshme nga ana e subjektit, para shqyrtimit në tërësi të çështjes, do të konsiderohej paragjykes në procesin ndaj subjektit të rivlerësimit⁴.

- 20.** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankimin drejtuar Kolegjit se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës lidhur me gjetjet dhe konstatimet në lidhje me vlerësimin e kriterit të figurës dhe atij të aftësive profesionale, por ka kërkuar sqarime me shprehjen standarde: *Subjekti të japë sqarime për konstatimin/konstatimet e mësipërme duke shoqëruar me dokumentacion.*

20.1. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se nuk qëndron pretendimi i subjektit se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës për vlerësimin e kriterit të figurës dhe të aftësive profesionale, duke kërkuar sqarime me shprehjet standarde. Nga raporti i rezultateve të hetimit, rezulton se në kuadër të kontrollit të figurës, Komisioni, pasi ka konstatuar se *ka mospërputhje në deklarimet e subjektit, sipas të cilit ai ka udhëtuar me mjetin me targë {***}, nga data 30.08.2013 – 31.08.2013, dhe të dhënave të sistemit TIMS, dhe se subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë emrin e pronarit të mjetit, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarimet e tij në lidhje me këto konstatime. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur shpjegimet e tij lidhur me mospërputhjet dhe pasaktësitë e regjistrimit të hyrjes së tij*

⁴ *Shih dhe vendimin e GjEDNj-së Xhoxhaj kundër Shqipërisë, sipas të cilit: “308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së”.*

në pikën kufitare, si dhe mbi pronësinë e automjetit me të cilin ka udhëtuar, fakt që dëshmon se subjekti është njohur me konstatimet e Komisionit dhe me barrën e provës për të dhënë sqarimet përkatëse. Edhe në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni, për disa nga çështjet penale të trajtuara prej tij, i ka kërkuar subjektit të japë sqarime në lidhje me konstatimet e evidentuara si dhe në lidhje me vijimësinë e trajtimit të kallëzimeve penale dhe ankimeve, duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Në analizë të rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në të kundërt nga sa pretendon subjekti, i ka kaluar atij barrën e provës në lidhje me çështjet që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ, për kriterin e vlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale, dhe dhënia e shpjegimeve përkatëse nga subjekti në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, si dhe në seancën dëgjimore e tejkalon këtë pretendim të tij, duke dëshmuar që subjekti e ka kuptuar drejt kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

20.2. Trupi gjykues vlerëson që shqyrtimi i pretendimeve konkrete lidhur me të drejtën për kalimin e barrës së provës, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional, të bëhet në vazhdim në këtë vendim.

- 21.** Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, duke qenë tërësisht paragjykues dhe në përpjekje të sforcuara për të argumentuar vendimin për shkarkimin e tij, ka bërë vlerësim të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara e të vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterëve të pasurisë, figurës dhe profesionalizmit, pasi nuk ka analizuar dhe nuk ka marrë në vlerësim të gjitha provat e administruara gjatë hetimit administrativ, duke cituar në mënyrë të pjesshme një pjesë të këtyre provave dhe i ka keqinterpretuar ato.

21.1. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, referuar akteve të administruara në fashikujt e Komisionit, dhe nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni ka kryer një proces vlerësues lidhur me vlerën provuese të akteve të paraqitura prej subjektit. Konstatohet se Komisioni në vlerësim të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës për disa nga gjetjet e tij, ka ndryshuar qëndrimin duke konkluduar ndryshe në vendimin përfundimtar. Konkretisht, në paragrafin 37 të vendimit, Komisioni shprehet se: *Në analizë të prapësimeve dhe në një vlerësim tërësor të fakteve dhe provave, në përfundim, Komisioni i konsideroi të bazuara pretendimet e subjektit dhe e konsideroi të gjithë kredinë në shumën 500.000 lekë, si burim për blerjen e mjetit objekt verifikimi.* Ndërsa në paragrafin 69 të vendimit, Komisioni shprehet se: *Sa i takon huasë së marrë nga babai i tij në vitin 2008, në analizë të dokumenteve që subjekti ka vënë në dispozicion në parashtrime, duke iu referuar në poshtëshënim akteve të paraqitura nga subjekti: kartelat e mbajtjes së librave kontabël për vitin 2008, për tri llogaritë e ortakëve dhe lëvizjet e llogarive të shoqërisë “{***}” ShPK në disa banka të nivelit të dytë, për periudhën 1 janar deri më 31.8.2008, dhe duke arritur në konkluzionin se në përfundim të procesit, u vlerësua se subjekti ka provuar bindshëm në lidhje me këtë hua. Lidhur me vlerësimin e kriterit profesional, në vendim, në paragrafin 89.3, Komisioni shprehet se: *Sa i takon pretendimit se shtetasi A. G. nuk ka qenë në masë arresti në burg, qëndron, pasi subjekti**

*paraqiti vendimin nr. {***}, datë 26.6.2014, të Gjykatës së Apelit, e cila ka vendosur ndryshimin e masës, duke i caktuar këtij shtetasi masën e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Trupi gjykues vëren se fakti që Komisioni nuk ka mbajtur gjithmonë qëndrim të njëjtë me sa është pretenduar nga subjekti në shpjegimet e tij, nuk përbën shkak për të pretenduar paragjykim në vlerësimin e provave, por është ushtrim prej Komisionit, i kompetencave dhe atributëve të tij analizuuese e vlerësuese, të njohura nga ligji nr. 84/2016, në funksion të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar këtë shkak ankimi të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.*

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së armëve pasi në disa vendime, pavarësisht se subjekteve u janë konstatuar shkelje të rënda procedurale dhe mangësi profesionale, janë kualifikuar të përshtatshëm profesionalisht, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në disa vendime të tij se: *Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni*⁵.
23. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, subjekti i rivlerësimit parashton në ankim se shkarkimi sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i mundur të bëhet duke u bazuar vetëm në një apo në dy nga kriteret, për arsye se kërkohet të ketë një cenim në një nivel të besueshëm të tri kriterëve së bashku për të vlerësuar pamundësinë e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë të subjektit për cenim të besimit të publikut.

23.1. Për këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se vetë përcaktimi i nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kërkon që prej Komisionit, konkluzioni për cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, duhet të jetë një produkt i dalë mbi vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit ose tërësor të procedurave, kur konkludohet se problematikat e konstatuara në drejtim të kontrollit të pasurisë, figurës apo aftësive profesionale, nuk mund të përbëjnë shkak shkarkimi më vete, por nga ana tjetër, ato mbartin elemente të mjaftueshme që, pas vlerësimit tërësor të këtyre tri kriterëve, të konkludohet se subjekti i rivlerësimit, me sjelljen apo qëndrimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në një nivel të tillë, të parikuperueshëm, aq sa kjo situatë të përcaktojë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁶.

23.2. Në rastin konkret, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ dhe ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve për subjektin e rivlerësimit, duke konkluduar se deklaratimet e pasakta e kontradiktore, në përpjekje për të fshehur vlerën reale të paguar për blerjen e automjetit apo mosdeklarimi i prindërve si persona të lidhur në deklaratën *vetting*, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, konstatimet nga hetimi administrativ, përfshirë edhe konstatimet në analizimin e çështjes “{***}” ShPK në lidhje me kriterin e figurës,

⁵ Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR); nr. 34/2021(JR); nr. 33/2022 (JR); nr. 35/2022 (JR).

⁶ Shih vendimin e Kolegjit nr. 37/2022 (JR), prg. 18.3.

si dhe konstatimi se subjekti ndodhet në kushtet e një konflikti në dukje të interesit gjatë trajtimit të çështjes objekt denoncimi nga shtetasi B. K., në vlerësimin e aftësive profesionale, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të çështjes, duke u konsideruar si elemente që cenojnë besimin e publikut te figura e subjektit si pjesë e sistemit të drejtësisë. Pra, ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni ka arritur në konkluzionin për cenim të besimit të publikut te drejtësia nga ana e subjektit, vetëm pas vlerësimit tërësor të rrethanave dhe nxjerrjes së konkluzioneve për të tria kriteret e rivlerësimit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

24. ***Për pasurinë automjet “Mercedes-Benz”, tipi “220 CDI”, blerë në vitin 2016***, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se është i pabazuar dhe në kundërshtim me të gjitha provat e administruara konkluzioni i Komisionit dhe se për këtë pasuri ai ka dhënë deklarime të pasakta dhe kontradiktore për të fshehur vlerën reale të paguar për blerjen e automjetit. Subjekti parashtron në ankim se nuk arrin të identifikojë në vendimin e Komisionit çfarë deklarimi të pasaktë dhe aq më tepër kontradiktor, ka bërë në lidhje me rrethanat e blerjes së këtij automjeti. Nga shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij në kuadër të barrë së provës, janë sqaruar rrethanat e blerjes së automjetit dhe nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se pretendimet dhe argumentet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe janë të pabazuara. Rezulton qartësisht e provuar se automjeti nuk është importuar nga shtetasja M. Zh. për t’u shitur, por ka qenë një dhuratë e djalit të saj që jeton në Itali. Sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka qenë pretendimi i tij se shitja e automjetit nga kjo shtetase është bërë për shkak të sëmundjes së saj, por ka qenë një pretendim i vajzës së saj, bazuar në deklaratën noteriale si dhe në kartelën mjekësore të shtetases M. Zh., të paraqitura gjatë hetimit administrativ dhe duket i paarsyeshëm arsyetimi i Komisionit se për shkak të moshës së shtetases M. Zh., me gjasa me probleme shëndetësore, mjeti mund të blihej në emër të vajzës së saj M. R..
25. Komisioni, për këtë pasuri, në përfundim të procesit, nuk gjeti arsye bindëse për të justifikuar objektivisht, ligjërisht dhe financiarisht blerjen e mjetit nga subjekti sa ½ e shumës që pala shitëse kishte shpenzuar vetëm një muaj e gjysmë më parë, ashtu sikurse nuk gjeti shkaqe objektive që të justifikojnë humbjen e konsiderueshme të pësuar nga pala shitëse. Për rrjedhojë, Komisioni ka krijuar bindjen se çmimi real i paguar nga subjekti për blerjen e mjetit, ka qenë të paktën 9.500 euro/1.285.065 lekë, plus 494.809 lekë zhdoganimi. Sipas Komisionit, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së mjetit prej 950.000 lekësh në kontratën e shitjes, në deklaratën periodike vjetore (në vijim “DPV”) të vitit 2016 dhe në deklaratën *vetting*, fakt i cili merr një peshë specifike të posaçme në kushtet kur të ardhurat e deklaruara si burim për blerjen e mjetit nga shitja e automjetit në vlerën 4.500 euro dhe kredi në shumën 500.000 lekë, nuk mjaftojnë për të justifikuar shumën 1.779.874 lekë në total.
26. Në deklaratën *vetting*, për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Mercedes-Benz”, tipi “220 CDI”. Burimi: Të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe kredi në shumën*

500.000 lekë, e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare. Vlera 980.000 lekë. Bashkëlidhur kontrata nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 26.12.2016, kontrata nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 26.12.2016 dhe kontrata e kredisë lidhur më 08.02.2016.

27. Të njëjtin deklaram për blerjen e automjetit ka bërë subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016, në të cilën ka deklaruar: *Blerë automjet “Mercedes Benz”, tipi “220 CDI”. Vlera 980.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi: Të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe kredi në shumën 500.000 lekë, marrë në Bankën Kombëtare Tregtare (kontrata nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 26.12.2016).*
28. Lidhur me këtë pasuri, nga aktet rezulton se sipas faturës së shitjes nr. {***}, datë 11.11.2016, “{***}” SRL (Itali) i ka shitur shtetas M. Zh., mjetin me targë {***}, vit prodhimi 2011, në shumën prej 9.500 eurosh dhe sipas deklaratës doganore të datës 12.11.2016, detyrimi doganor rezulton në shumën 494.809 lekë. Sipas akteve të përcjella në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, dokumenti doganor “Urdhër çlirimi” figuron në emër të znj. M. Zh.. Vlera totale e shpenzuar nga shitësja, është në shumën 1.779.874 lekë⁷. Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.12.2016, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasja M. V. Zh., mjetin në shumën 980.000 lekë.
29. Komisioni ka evidentuar nga përmbajtja e kontratës se: (i) shitësja M. Zh. i ka propozuar blerësit Juljan Xhengo shitjen e mjetit që në datën 09.11.2016 dhe ky ka qenë i lidhur me këtë propozim, deri në datën 26.12.2016, kur e bleu mjetin të zhdoganuar; (ii) mjeti është blerë rreth dy herë më ulët se vlera e paguar nga pala shitëse për blerjen e këtij mjeti dhe pagesën e shpenzimeve doganore.
30. Në verifikim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është njohur që në rezultatet e hetimit me konstatimin e Komisionit se *ai është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë vlerën reale të blerjes së mjetit në DPV për vitin 2016 dhe në deklaratën vetting*. Komisioni ka arritur në konkluzionin për pasaktësi në deklaram pasi ka krijuar bindjen se çmimi i blerjes së automjetit në kontratë dhe i deklaruar nga subjekti, nuk është çmimi real i blerjes. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion pas hetimit të kryer dhe vlerësimit të rrethanave faktike të blerjes së automjetit, të argumentuara dhe pasqyruara në vendimin përfundimtar, dhe është i pabazuar pretendimi i subjektit se nuk arrin të identifikojë pse Komisioni ka arritur në këto konkluzione. Konkretisht në vendim, në paragrafin 30, Komisioni shprehet se: *Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë autoveturë, me targë {***}, subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me konstatimet se subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë vlerën reale të blerjes së automjetit në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën vetting, pasi [...] deklarimet e subjektit bien në kundërshtim me parashikimin në kontratën e shitjes të datës 26.12.2016, sipas së cilës, shitësja M. Zh. i ka propozuar blerësit Julian Xhengo shitjen e mjetit që në datën 9.11.2016, pra dy ditë para blerjes nga ana e saj, në datën*

⁷ Kursi këmbimit: 1 euro = 135,27 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2016.

11.11.2016, propozim të cilin ai e pranoi ditën e lidhjes së kontratës dhe është e pajustificuar financiarisht dhe objektivisht blerja e mjetit nga subjekti rreth dy herë më ulët se vlera e paguar nga pala shitëse një muaj e gjysmë më parë.

31. Për sa i përket propozimit për shitjen e automjetit, subjekti i rivlerësimit pretendon se data e pasqyruar si datë propozimi në kontratën e shitblerjes, është gabim material i noterit. Sipas subjektit, nuk ka asnjë të dhënë, indicie apo provë si mund të ketë marrë dijeni subjekti i rivlerësimit për propozimin për shitjen e këtij automjeti, pasi thjesht një fakt i tillë nuk ka ndodhur. Propozimi për blerjen e automjetit përpara se shtetasja M. Zh. të bëhej pronare do të ekzistonte vetëm në rastin nëse kjo shtetase ishte tregtare në blerjen dhe shitjen e automjeteve. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me ankimin në Kolegj, deklaratën noteriale të noterit I. H., të datës 14.11.2022, në të cilën noteri deklaroi se: *Me kërkesë të të interesuarit, i cili më kërkoi të sqaroj nëse data 09.11.2016, është data e propozimit të parë, sqaroj se data mund të jetë edhe gabim meqenëse aktet punohen në kompjuter, shpesh edhe duke u kopjuar si "template".*
32. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vëren se pavarësisht sa parashtron ai, në mungesë të indicieve dhe akteve të tjera, i vetmi dokument për vlerësim mbetet kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.12.2016, në të cilën thuhet: *Lidhja dhe përfundimi i kësaj kontrate është propozuar nga shitësi sipas paragrafit të parë të nenit 665 të Kodit Civil, në datën 09.11.2016, duke vërtetuar propozimin dhe ka qenë i lidhur me këtë propozim deri në momentin e pranimit nga ana e blerësit. Propozimi i shitësit është kryer sipas nenit 665/2 të Kodit Civil dhe përgjigjja e blerësit ka ardhur sot, në datën që ky akt noterial mban.* Trupi gjykues çmon se mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit se nuk i ka kushtuar vëmendje këtij paragrafi në nënshkrimin e kontratës, për më tepër kur bëhet fjalë për paragrafin më të rëndësishëm, i cili përcakton termat bazë të kontratës dhe pas verifikimit të këtij akti në pikëpamje vizuale, rezultoi se bëhej fjalë për një paragraf që dallohej nga pjesa tjetër e dokumentit, pasi ka qenë dukshëm me shkronja më të vogla.
33. Subjekti pretendon gjithashtu se është e provuar nga aktet e paraqitura në Komision, se vlera reale e blerjes së automjetit është 980.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 26.12.2016, dhe është i pabazuar qëndrimi i Komisionit që në analizën financiare të vitit 2016, ka përfshirë si vlerë/shpenzim çmimin e blerjes së automjetit në Itali, 9.500 euro, dhe detyrimin doganor, 494.809 lekë, në vlerën totale 1.779.874 lekë. Sipas subjektit, Komisioni përdor dy standarde arsyetimi për vlerën provuese të kontratës.
34. Për sa i përket këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, bazuar në rrethanat, si: propozimi për shitje para zhdoganimit, si dhe blerja nga subjekti me vlerë gati sa gjysma e vlerës së blerjes dhe zhdoganimit, ka konkluduar se vlera reale e blerjes nuk është 980.000 lekë, por të paktën 9.500 euro (1.285.065 lekë), plus vlerën e zhdoganimit prej 494.809 lekësh.
35. Lidhur me pretendimin se Komisioni në lidhje me kontratën e shitblerjes përdor dy standarde arsyetimi, pasi në rastin e propozimit për shitje shprehet se kontrata është një akt shkresor me fuqi

të plotë provuese që vërteton se palët kanë qenë në një marrëveshje/marrëdhënie të përbashkët, ndërkohë që nuk pranon çmimin e dakordësuar midis palëve në kontratë, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka argumentuar se çmimi sipas kontratës, nuk është i saktë, duke rrëzuar fuqinë provuese të aktit shkresor, pasi nuk gjeti arsye bindëse në shpjegimet e dhëna nga subjekti për të justifikuar financiarisht blerjen e automjetit me çmimin e dakordësuar midis palëve. Trupi gjykues, duke ndarë të njëjtin qëndrim me Komisionin për deklarime të pasakta dhe kontradiktore në përgjigje të pretendimit të subjektit për vlerën provuese të kontratës, vëren se pavarësisht se në kuptim të ligjit, kontratat përbëjnë provë të plotë, të dhënat e tyre duhen parë dhe vlerësuar në harmoni me rrethanat faktike, që në rastin konkret tregojnë për një qasje të ndryshme të subjektit në raport me të dhënat e pasqyruara në aktin formal të kontratës.

36. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se për pasurinë automjet "Mercedes-Benz", tipi "220 CDI", blerë në vitin 2016, subjekti nuk arrin të përmbysë barrën e provës për të provuar vlerën e blerjes të pasqyruar si çmim në kontratën e shitjes, dhe është i bazuar qëndrimi i Komisionit që në përfundim, si vlerë për blerjen e automjetit, ka konsideruar shumën 1.779.874 lekë.
37. Ky konkluzion i trupit gjykues hedh poshtë dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se do të korrigjohej në pozitive balanca negative prej -626.453 lekësh, për gjithë vitin 2016, që ka ardhur vetëm si rezultat i njohjes së blerjes së automjetit në shumën 1.779.874 lekë, dhe jo aq sa është deklaruar midis palëve në kontratën e shitblerjes së automjetit, në shumën 980.000 lekë. Subjekti ka pretenduar për korrigjimin e analizës të gjithë vitit 2016, ndërsa Komisioni ka konkluduar se nga analiza financiare deri në datën 26.12.2016, subjekti nuk ka pasur mundësi për pagimin e shumës prej 1.779.874 lekësh për blerjen e automjetit, për shkak të një balance negative prej 397.603 lekësh. Për rrjedhojë, Kolegji, duke i qëndruar konkluzionit të Komisionit, konfirmon balancën negative prej 397.603 lekësh, deri në momentin e blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit, në datën 26.12.2016.
38. Për pasurinë e deklaruar nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2006, shtëpi banimi 1-katëshe, me sip. 120 m², Tiranë, Komisioni nga hetimi ka konstatuar se, sipas certifikatës së pronësisë, lëshuar më datë 7.7.2017, nga ZVRPP-ja Tiranë, rezulton në pronësi të babait të subjektit E. Xh., pasuria godinë banimi me 3 kate, e regjistruar në datën 10.08.2013, sipas lejes së legalizimit nr. {***}, datë 31.05.2012. Komisioni për këtë pasuri ka konkluduar se ka pasaktësi në deklaratën *vetting*, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar prindërit si persona të lidhur, të cilët duhet të deklaronin pasurinë objekt verifikimi. Pavarësisht se në përfundim nuk ka evidentuar problematika në këtë pasuri, Komisioni ka mbajtur qëndrimin se ndarja e subjektit nga trangu familjar tre muaj përpara se të plotësonte deklaratën *vetting*, duket se është bërë pikërisht për t'iu shmangur deklarimit të pasurisë në këtë deklaratë. Sipas Komisionit, argumentet që subjekti ka paraqitur për shkaqet e shkëputjes nga trangu familjar tre muaj para plotësimit të deklaratës *vetting*, janë të paqarta dhe jobindëse.
39. Lidhur me mosdeklarimin e prindërve si persona të lidhur, subjekti pretendon se për sa kohë ka jetuar nga emërimi në detyrë dhe në vazhdim në një ekonomi tërësisht të ndarë nga prindërit, ndarja

nga certifikata familjare është një akt formal dhe pa pasoja për të si subjekt rivlerësimi. Subjekti sqaron se në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, i është referuar udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, në pikën 3 të të cilit parashikohet se deklarata duhet të shoqërohet me certifikatën personale dhe familjare të subjektit, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit. Sipas subjektit, deklarata e tij është pranuar nga ILDKPKI-ja, duke vlerësuar se prindërit nuk janë persona të lidhur pasi nuk ka ngritur ndonjëherë ndonjë pretendim apo kërkesë si për dorëzimin e deklaratës për personat e lidhur, ashtu edhe për dokumentet e identifikimit të prindërve. Subjekti kërkon nga Kolegji që nëse në përfundim, do të vlerësojë se prindërit e tij janë persona të lidhur, duke pasur parasysh paqartësinë që ka ekzistuar mbi këtë detyrim në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, si dhe faktin se nga hetimi administrativ në Komision nuk ka rezultuar se prindërit kanë pasuri të pajustificuara ligjërisht, në vlerësim të parimit të proporcionalitetit, kjo të konsiderohet një pasaktësi formale që nuk ndikon në marrjen e vendimit përfundimtar.

40. Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstaton nga aktet në fashikujt e Komisionit, se sipas certifikatës familjare të datës 29.7.2020, subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë përbërëse e familjes prindërore deri në datën 17.10.2016, ndërsa pas kësaj date, gjendja familjare përbëhet vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në datën 8.10.2016⁸, subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit. Për efekt të këtij ligji, bazuar në parashikimet e pikës 13⁹ të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, prindërit e subjektit të rivlerësimit, për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare, konsiderohen persona të lidhur që kanë pasur detyrimin për të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke bashkëlidhur gjithë dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të pasurive të tyre. Ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar disa ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016¹⁰, nuk ka përjashtuar nga detyrimi ligjor për deklarimin e pasurive në deklaratën *vetting* prindërit e tij, të cilët kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se është përbërja e certifikatës familjare për gjithë periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, ajo që përcakton rrethin e personave të lidhur që duhet të deklarojnë, në kuptim të nenit 3, pika 13, dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se prindërit e subjektit janë persona të lidhur dhe me mosdeklarimin e tyre në deklaratën *vetting*, subjekti ka shmangur detyrimin për deklarim të pasurisë dhe të interesave privatë të personave të lidhur.

⁸ Ligji nr. 84/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016.

⁹ ““Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.

¹⁰ Sipas akteve në fashikuj, më datë 17.10.2016.

41. Lidhur me vendimet e Komisionit¹¹ që referon subjekti në ankim, në të cilat, sipas tij, nuk janë trajtuar prindërit si persona të lidhur, edhe pse ata kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në periudhën e rivlerësimit, trupi gjykues përsërit qëndrimin se Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi për situatën faktike konkrete të subjektit dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera, për subjekte të tjera rivlerësi¹².
42. Në vlerësimin përfundimtar, trupi gjykues e gjen të bazuar qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*, pasi nuk ka deklaruar pasuritë e familjarëve të tij, të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kishin detyrimin që të deklaronin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit.
43. Trupi gjykues mori në shqyrtim dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për reduktimin e kostove të ndërtimit të banesës, për shkak të zbritjes së vlerës së TVSh-së së pagueshme dhe pagesës së kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pasi punimet janë kryer nga familjarë dhe të njohur, duke vlerësuar se këto pretendime nuk janë relevante, për sa kohë që konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, është se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur burime financiare të ligjshme dhe analiza financiare për vitet 2007-2011, rezulton me balancë pozitive.
44. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të Komisionit, balanca negative e vitit 2010 vjen për shkak se Komisioni nuk ka njohur gjendjen në *cash* prej 6.000 eurosh, aq sa ka qenë vlera reale e shitjes së automjetit tip “Wolkswagen Golf”, por ka njohur vetëm vlerën prej 530.000 lekësh, sa ka qenë vlera e blerjes, trupi gjykues konstaton nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit se:
- 44.1. Në DPV 2007, subjekti ka deklaruar blerjen në shumën 500.000 lekë të automjetit tip “Golf Wolkswagen”. Në DPV 2009, subjekti ka deklaruar: *Shitur automjet, tip “Golf Wolkswagen”, për shumën 6.000 euro dhe “Cash 6.000 euro”, ndërsa në DPV 2010, ka deklaruar: Pakësuar gjendja e parave cash nga shitja e automjetit “Volkswagen Golf”, 6.000 euro.*
- 44.2. Sipas kontratës¹³ së shitblerjes së automjetit nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.12.2009, subjekti u ka shitur shtetasve R. K. Xh. dhe R. R. Xh., mjetin me targë {***}, të markës “Wolkswagen Golf”, në shumën 6.000 euro.
- 44.3. Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.03.2022, të shtetasit B. Z., sipas së cilës ky shtetas i ka shitur

¹¹ Vendimet nr. 157/2019, nr. 185/2019, nr. 410/2021, nr. 517/2022 të Komisionit.

¹² Shih vendimin nr. 33/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹³ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 11.02.2022, të ILDKPKI-së.

subjektit, më datë 06.01.2009, automjetin “Wolkswagen Golf”, me targë {***}, me çmimin prej 530.000 lekësh.

44.4. Komisioni, në analizën e vitit 2009, duke pranuar sqarimet e subjektit se vlera reale e blerjes së automjetit ka qenë 530.000 lekë, ka konsideruar si të ardhur të ligjshme nga shitja e automjetit “Wolkswagen Golf”, vlerën e çmimit të blerjes së automjetit, dhe jo vlerën e shitjes prej 6.000 eurosh, sipas kontratës së shitjes nr. {***}, datë 2.12.2009, dhe si likuiditete *cash* në vitin 2009 ka konsideruar po vlerën prej 530.000 lekësh. Komisioni, në pyetësin nr. 3, ka pyetur subjektin lidhur me çmimin e shitjes më të lartë se çmimi i blerjes, dhe subjekti ka deklaruar se automjetit i ka kryer shërbime dhe e ka përmirësuar. Komisioni, në përfundim të analizës së dokumenteve dhe deklaramëve të subjektit, ka konkluduar se automjeti është shitur në datën 2.12.2009, në shumën 6.000 euro, pra, më shumë nga çmimi i blerjes, por meqenëse subjekti nuk ka provuar me dokumentacion shpenzimet e kryera për përmirësimin e këtij mjete, në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga shitja janë konsideruar në vlerën 530.000 lekë, aq sa kanë shërbyer për blerjen e automjetit.

45. Subjekti në ankim parashton se përveç çmimit të blerjes së automjetit “Wolkswagen Golf”, ka shpenzuar edhe vlera të tjera monetare për këtë automjet. Në deklaratimet periodike të kryera në këtë periudhë, nuk ka qenë i parashikuar detyrimi i deklarimit të shpenzimeve dhe mbajtjes së dokumentacionit justifikues ligjor dhe, për këtë arsye, subjekti e ka pasur të pamundur të sigurojë faturat për shërbimet që janë kryer gjatë viteve 2007 – 2009, për këtë automjet. Për sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore për diferencën e rezultuar nga shitja e automjetit, subjekti prapëson se në rastet e fitimit, për individët tatohet vetëm kalimi i së drejtës së pronësisë të pasurive të paluajtshme.
46. Në vlerësim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e disa shpenzimeve për përmirësimin e automjetit nuk janë shoqëruar me deklarata/vërtetime, nëpërmjet të cilave do të mund të provohej kryerja e tyre, pavarësisht se dokumentimi dhe deklarimi i këtyre shpenzimeve për periudhën në fjalë nuk përbënte detyrim ligjor në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Për rrjedhojë, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se duke qenë se subjekti nuk ka provuar shpenzimet e kryera për përmirësimin e automjetit, në analizën financiare të vitit 2010, të ardhurat e përfituara nga shitja e tij duhen konsideruar të barabarta me vlerën që ka shërbyer për blerjen, në vlerën 530.000 lekë. Në vijim të këtij konkluzioni, mbeten të pabazuara dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e analizës financiare të vitit 2010, për shkak të mospranimit të vlerës së të ardhurave të pretenduara nga shitja e automjetit.
47. Lidhur me konstatimet e Komisionit se subjekti ka dështuar në vërtetimin e marrëdhënies së qiramarrjes për banesën me qira ku pretendon se ka jetuar në periudhën janar 2016 - janar 2017, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se kontrata e qirasë me shtetasen I. B. është lidhur verbalisht për shkak se afati i kësaj kontrate nuk ka qenë mbi një vit, që të kërkohej formë shkresore sipas nenit 803/4 të Kodit Civil, dhe se detyrimi tatimor për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga

qiraja, është detyrim i qiradhënësës e cila nuk e ka përmbushur këtë detyrim, dhe për të mos deklaruar të ardhurat dhe për të paguar detyrimin tatimor me vonesë, ka refuzuar edhe kërkesën e bashkëshortes së subjektit për lëshimin e një deklarate noteriale që do të konfirmonte qëndrimin në apartamentin me qira.

48. Nga aktet, rezulton se në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se në periudhën janar 2016 - janar 2017, ka banuar me qira, së bashku me bashkëjetuesen, në adresën: rruga “{***}”, Pall. {***}, Shk. {***}, Ap. {***}, Tiranë, në pronësi të I. B.. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision, nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që të provojë marrëdhënien e qirasë, por ka sjellë kopje të librezave të pagesës së energjisë elektrike dhe të ujit, në emër të shtetasit A. B. (bashkëshorti i qiradhënësës). Në seancën dëgjimore në Komision, subjekti ka pretenduar se i është refuzuar një deklaratë nga I. B., për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore nga ana e saj. Ndërkohë, në DPV-në 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një adresë vendqëndrimi tjetër: rruga “{***}”, Tiranë, për të cilën ka pretenduar se ka qenë një lapsus.
49. Nga kontrolli i vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se Komisioni, si konstatim dhe pasojë kryesore lidhur me marrëdhënien e qirasë të deklaruar nga subjekti, ka vlerësuar faktin se subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj banese në deklaratën *vetting*, por e ka dhënë vetëm si adresë banimi, pa arritur të sqarojë marrëdhënien me këtë pasuri. Ashtu si dhe ka rezultuar nga hetimi në Komision, trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka arritur të provojë marrëdhënien e qirasë, pasi nuk ka paraqitur një kontratë qiraje, si dhe nuk ka të dhëna për pagimin e detyrimeve tatimore, pranuar edhe nga vetë subjekti në ankimin drejtuar Kolegjit. Gjithashtu, rezulton se dhe vetë subjekti ka dhënë deklarime të ndryshme për adresën e banimit për periudhën 2016 - janar 2017 në deklaratën *vetting* dhe në DPV-në 2016. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mbetet i bazuar konstatimi i Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht përdorimin e kësaj pasurie/apartamenti dhe se mbetet e paqartë nëse subjekti ka banuar vërtet në apartamentin në fjalë.
50. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të vendimit nr. 560, datë 14.09.2022, konfirmon gjetjet dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për mosdeklarimin e prindërve si persona të lidhur¹⁴, konsiderimin në analizën financiare të vitit 2010 të të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit “Wolkswagen Golf” në vlerën 530.000 lekë që ka shërbyer për blerjen e mjetit, për deklarim të pasaktë të subjektit të rivlerësimit për vlerën reale të blerjes së automjetit “Mercedes-Benz” në vitin 2016, si dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e tij, që rezulton nga balanca negative prej 397.603 lekësh, sipas analizës financiare deri në momentin e blerjes në vitin 2016. Por, në ndryshim nga qëndrimi i Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se rrethanat e mësipërme të lidhura vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk mund të konsiderohen si elemente të mjaftueshme për të konkluduar që kanë cenuar

¹⁴ Pavarësisht këtij konstatimi, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se nga analiza e rishikuar financiare pas marrjes në konsideratë të disa pretendimeve, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për investimin në pasurinë objekt verifikimi.

besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të figurës

51. Sipas raportit të DSIK-së të datës 02.11.2017, subjekti ka plotësuar saktësisht formularin për kontrollin e figurës dhe është vlerësuar i përshtatshëm për ushtrimin e detyrës. Në vijim, më datë 21.06.2021, DSIK-ja ka përcjellë në Komision një raport tjetër, në të cilin ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo, bazuar në disa informacione konfidenciale të organeve ligjzbatuese, ku evidentohet se gjatë periudhës në të cilën z. Julian Xhengo ushtronte detyrën si prokuror, dyshohet se është përfshirë në veprimtari korruptive, si dhe disponohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
52. Pas verifikimit të informacioneve të vëna në dispozicion nga institucionet ligjzbatuese, si dhe të një denoncimi, në përfundim të hetimit sa i takon udhëtimit të subjektit të rivlerësimit me mjetin me targë {***}, Komisioni ka konstatuar se: (i) nga aktet e dosjes nuk rezulton që ky mjet të ketë qenë ndonjëherë në pronësi të shtetasit P. Gj., sikurse subjekti ka deklaruar; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë emrin e pronarit të mjetit, që pas verifikimeve rezultoi të jetë shtetasi S. Sh., person i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar.
53. Në prapësimet ndaj rezultateve hetimore, subjekti ka sqaruar se për herë të parë nëpërmjet rezultateve të hetimit, ka mësuar faktin që automjeti në atë kohë ka qenë në pronësi të shtetasit S. Sh., për të cilin ka deklaruar se nuk e ka njohur asnjëherë, si dhe nuk ka pasur asnjë lloj kontakti/marrëdhënieje të çfarëdolloj natyre me të.
54. Komisioni i ka vlerësuar të dyshimta deklaratimet e subjektit, të cilat duket se janë me qëllim për të fshehur faktin që mjeti ka qenë në pronësi të shtetasit S. Sh., person me precedent penal. Komisioni nuk evidentoi kontakte të subjektit me shtetasin S. Sh., por mosveprimet e tij për një përgjigje të saktë dhe shteruese në lidhje me pronësinë e mjetit, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të çështjes.
55. Në përfundim të vlerësimit të figurës, Komisioni nuk arriti në përfundimin se subjekti Julian Xhengo është i papërshtatshëm, por nga përfundimet e mësipërme lidhur me përdorimin e automjetit, përfshirë edhe konstatimet në analizimin e çështjes “{***}” ShPK (trajtuar tek aftësitë profesionale), ka çmuar se ka elemente që cenojnë besimin e publikut nga subjekti i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë.
56. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit për këtë kriter, lidhur me pretendimin e subjektit se nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me kriterin e figurës, trupi gjykues konstaton se, ashtu si dhe referon dhe vetë subjekti në ankimin drejtuar Kolegjit, Komisioni, në rezultatet e hetimit, në rubrikën III, “Kontrolli i figurës”, pasi ka vënë në dijeni subjektin mbi përmbajtjen e raportit të DSIK-së, i ka

kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet dhe përfundimet e arritura nga ky raport. Gjithashtu, subjekti është njohur në rezultatet e hetimit edhe me gjetje të tjera të Komisionit, në kuadër të kontrollit të figurës, pas kryerjes së veprimeve hetimore nga ky i fundit në drejtim të verifikimit të informacioneve të ardhura nga institucionet ligjzbatuese, për të cilat i janë kërkuar të japë sqarime. Ndërmjet gjetjeve të konstatuara nga Komisioni dhe për të cilat janë kërkuar sqarime, janë dhe çështjet që kanë të bëjnë me udhëtimin e subjektit me automjetin që ka rezultuar në pronësi të shtetasit S. Sh.. Gjithashtu, konstatohet se në dokumentin “Prapësime në përgjigje të barrës së provës dhe kërkesave për shpjegime mbi rezultatet e hetimit administrativ”, të paraqitur në Komision më datë 06.09.2022, subjekti i rivlerësimit në faqet 37-49 të këtij dokumenti, ka dhënë konstatimet dhe shpjegimet e tij lidhur me gjetjet që kanë rezultuar për kontrollin e figurës nga rezultatet e hetimit. Konkretisht, subjekti ka propozuar se: *Përfundimisht, deklaroj edhe një herë se shtetasin S. Sh. nuk e njoh dhe nuk e kam njohur asnjëherë, nuk e kam idenë çfarë përfaqëson dhe me çfarë është marrë në jetë ky shtetas, se nuk kam pasur asnjë lloj kontakti të çfarëdolloj natyre me të, se nuk kam pasur as marrëdhënie të karakterit shoqëror, as marrëdhënie të karakterit pasuror (huamarrje, huadhënie, dhurim etj., etj.), se nuk e kam pasur ndonjëherë subjekt procedural (kallëzues, të kallëzuar, person nën hetim, të pandehur apo qoftë edhe dëshmitar) në ndonjë procedim penal të hetuar prej meje dhe se nuk do kisha asnjë pengesë, arsye apo motiv që të mos deklaroja faktin që automjeti në fjalë në kohën e udhëtimit tim me kolegët për në Mal të Zi, ka qenë në pronësi të këtij shtetasi.* Nga përmbajtja e këtij dokumenti dhe sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se pavarësisht se e ka kundërshtuar raportin e DSIK-së se nuk përmban asnjë nga elementet e parashikuara nga neni 38, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti e ka perceptuar këtë dokument si përgjigje ndaj barrës së provës, duke dhënë dhe shpjegimet, shoqëruar me aktet që ka konsideruar si të nevojshme. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mbetet i pabazuar pretendimi i subjektit se nga Komisioni nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me kontrollin e figurës.

57. Subjekti parashtron në ankim se në rezultatet e hetimit dhe në seancën dëgjimore, nuk i është kërkuar ndonjë sqarim për informacionet në lidhje me çështjen penale që i takon shoqërisë “{***}” ShPK, duke referuar paragrafin 83.3¹⁵ të vendimit të Komisionit. Subjekti parashtron se nuk është e qartë se cilat informacione konfidenciale ka pasur Komisioni dhe për çfarë veprimtarie të kundërligjshme bëhet fjalë, dhe përmendja në vendim e tyre është bërë në funksion të arritjes së një konkluzioni të sforcuar për ekzistencën e elementeve që cenojnë besimin e publikut. Komisioni në kushtet kur nuk ka pasur asnjë fakt apo provë për kualifikimin si të papërshtatshëm për kriterin

¹⁵ “Në lidhje me çështjen penale që i takon shoqërisë “{***}” ShPK, sipas informacioneve konfidenciale, ngriheshin dyshime për veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit. Me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti dhe vlerësimin sa më objektiv në raport me këto informacione, Komisioni administroi dosjen penale të kësaj çështjeje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në lidhje me këtë çështje, është paraqitur edhe denoncimi nga shtetasi Q. B., i cili ngre pretendimin për korrupsion ndaj subjektit, sa i takon trajtimin të kallëzimit nga ana e tij për punonjësit e {***}-së, për shpërdorim detyre, testim investimesh të pakryera, fatura dhe situacione fiktive për shoqërinë “{***}” ShPK (trajtuar te rubrika “Vlerësimi i aftësive profesionale”).

e figurës, nisur nga pozita paragjykuese dhe me qëllimin për të përligjur vendimin e shkarkimit për shkak të cenimit të besimit të publikut, përmend në këtë moment informacionet konfidenciale në lidhje me veprimtari të kundërligjshme në çështjen penale nr. {***}, në një mënyrë joobjektive dhe jo të logjikshme. Për sa i përket denoncimit të shtetasit Q. B., subjekti parashtron se ky denoncim ka lidhje me çështjen penale nr. {***} të vitit 2013, dhe se ky denoncim është trajtuar nga Komisioni në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe ka konkluduar se pretendimet e denoncuesit në lidhje me korrupsionin mbeten të pavërtetuara.

57.1 Lidhur me sa parashtron subjekti i rivlerësimit, rezulton se në rezultatet e hetimit, Komisioni është shprehur se: *3. Në lidhje me çështjen penale sa i takon shoqërisë “{***}” ShPK, sipas informacioneve konfidenciale, ngriheshin dyshime për veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit. Me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti dhe vlerësimin sa me objektiv në raport me këto informacione, Komisioni administroi dosjen penale të kësaj çështjeje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (trajtuar në rubrikën “Rivlerësimi i aftësive profesionale”). Nga ky konstatim i Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë i informuar se për cilën çështje penale të hetuar prej tij ka pasur dyshime për veprimtari të kundërligjshme, dhe se Komisioni me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti, ka administruar dosjen penale përkatëse. Vetë subjekti ka paraqitur në Komision prapësime për këtë procedim penal, dhe mbetet i pabazuar pretendimi i tij se në rezultatet e hetimit dhe në seancën dëgjimore nuk i është kërkuar ndonjë sqarim për informacionet në lidhje me çështjen penale që lidhet me shoqërinë “{***}” ShPK.*

57.2 Por ndërkohë, trupi gjykues vlerëson si të pabazuar dhe kontradiktor konkluzionin e Komisionit se në vlerësimin e kriterit të figurës, ka elemente që cenojnë besimin e publikut të subjekti, duke iu referuar konstatimeve në analizimin e çështjes “{***}” ShPK (trajtuar tek aftësitë profesionale), pasi rezulton se në përfundim të vlerësimit për këtë çështje, vetë Komisioni ka konkluduar se pretendimet e denoncuesit në lidhje me korrupsionin, mbeten të pavërtetuara, duke mos u dhënë peshë problematikave të konstatuara në këtë çështje në drejtim të kriterit të kontrollit të figurës.

58. Subjekti vlerëson të pabazuara konstatimet e Komisionit se deklaratimet e tij për pronësinë e mjetit me targë {***}, mbeten të dyshimta dhe duket se janë me qëllim për të fshehur faktin që mjeti ka qenë në pronësi të shtetasit S.Sh.. Sipas subjektit të rivlerësimit, në pyetësorin nr. 2, pyetja 16, i është kërkuar informacion në lidhje me pronarët e automjeteve, por jo dokumentacion ku të pasqyrohej pronësia e automjeteve në fjalë. Vetëm në rezultatet e hetimit subjekti ka ardhur në dijeni të faktit që automjeti nuk ka qenë në pronësi të shtetasit P. Gj., por në pronësi të shtetasit S. Sh., person i përfshirë në krimin e organizuar. Subjekti parashtron se nuk ka pasur asnjë motiv për të fshehur faktin që automjeti ka qenë në pronësi të një personi të cilin nuk e njihete, ashtu si nuk njihete dhe personin tjetër P. Gj. që gabimisht e ka deklaruar pronar. Subjekti ka sqaruar në Komision se e vetmja arsye pse ka udhëtuar me këtë automjet, ka qenë fakti që drejtuesi, N. P., ka qenë i njohur i kolegut të tij A. D..

59. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me deklarinimin për pronarin e automjetit me targë {***}, nga verifikimi i akteve rezultoi se në pyetësin nr. 2, subjektit të rivlerësimit i është bërë pyetje: *16. Nga të dhënat e sistemit TIMS, rezultoi se ju keni udhëtuar jashtë shtetit me automjetet me targa: {***}; {***}; {***}; {***}; {***}; {***}; {***}. Lutemi jepni informacion mbi pronarët e automjeteve, marrëdhënien tuaj me ta, si dhe qëllimin e udhëtimit. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti i rivlerësimit ka informuar se: Automjeti me targë {***}, në datat 30.08.2013 - 31.08.2013, nga verifikimet që kam bërë, ka qenë në pronësi të shtetasit P. Gj.. Nuk kam të dhëna kush mund të jetë ky shtetas. Qëllimi i rrugës që unë kam bërë, ka qenë qëndrimi për një natë në Podgoricë, Mali i Zi, me kolegët A. D. dhe E. B.. Në drejtimin e automjetit ka qenë shtetasi N. P. (avokat), i cili ishte i njohur i kolegut A. D..*
60. Për sa përshtron subjekti i rivlerësimit, konstatohet nga aktet se ai është vënë në dijeni të detyrimit që ka pasur për të dhënë informacion mbi pronarët e automjeteve që ka udhëtuar jashtë, që në pyetësin nr. 2, ku nga Komisioni, pasi janë konstatuar të dhëna nga sistemi TIMS, është pyetur subjekti mbi pronarët e automjeteve me të cilët ka udhëtuar, marrëdhënien me ta, si dhe qëllimin e udhëtimit. Gjithashtu, nga rezultatet e hetimit, Komisioni ka konstatuar se nga verifikimi i të dhënave në sistemin AMF, rezultoi se pronar i mjetit me targë {***}, figuron shtetasi S. Sh., dhe jo shtetasi P. Gj., sikurse kishte deklaruar subjekti. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se deklarimi i emrit të shtetasit P. Gj., gabimisht si pronar i mjetit, ka ardhur pas një informacioni nga një punonjës i DRSHTRR-së Tiranë, nëpërmjet komunikimit me WhatsApp (të cilit ai i ka kërkuar emrat e pronarëve të automjeteve, pasi Komisioni i ka kërkuar shpjegime). Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur në Komision printimin e një liste me emra, ku në rubrikën “Historiku i lejeve dhe targave”, në kolonën “Përdorues” vërehet emri P. Gj.. Sipas subjektit, pikërisht ky emër është deklaruar gabimisht prej tij si pronar i mjetit.
61. Për sa paraqitur më sipër, trupi gjyqës vëren, në ndryshim nga vlerësimi i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e pasagjerit në këtë automjet, ka bërë përpjekje për të sqaruar rrethanat e përdorimit të automjetit, si dhe për të marrë të dhëna në lidhje me pronësinë e mjetit. Mbetet i pabazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit, me deklarinimet e tij, ka pasur si qëllim të fshehtë faktin se automjeti ka qenë në pronësi të një shtetasi me precedentë penalë. Gabimi në deklarinimin e pronarit të automjetit, në mungesë të të dhënave të tjera për dijeninë apo kontakte nga ana e subjektit me pronarin e vërtetë të automjetit, nuk mund të konsiderohet si një shkak relevant penalizues ndaj subjektit në drejtim të vlerësimit të kriterit të figurës, apo për mbajtjen në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe kualifikimin si shkelje që cenon besimin e publikut të sistemit të drejtësisë.
62. Subjekti i rivlerësimit kundërshton dhe konstatimin e Komisionit se bëhet i pabesueshëm deklarimi i subjektit se nuk kishte dijeni për pronësinë e automjetit, pasi ish-kolegu i tij që udhëtonte bashkë me të, subjekt rivlerësimi, është pyetur dhe përgjigjur lidhur me këtë fakt. Subjekti prapëson se, së pari, ka qenë ai vetë që në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit, ka sjellë në vëmendje të Komisionit se në këtë udhëtim ka qenë i shoqëruar me dy kolegë të tij, që i janë nënshtruar procesit të

rivlerësimit dhe të cilët duhet të kenë dhënë shpjegime në lidhje me këtë moment. Vetë subjekti nuk ka pasur dijeni në detaje për procesin e rivlerësimit të kolegëve, dhe as për vendimet e dhëna ndaj tyre, pavarësisht prezumimit të Komisionit të njohjes për shkak të publikimit të vendimeve. Vetëm pasi është njohur me vendimin e Komisionit për shkarkimin e tij, subjekti është njohur nga faqja zyrtare e Komisionit me vendimet për subjektin e rivlerësimit E. B. (për të cilin nuk rezultoi të jetë përmendur në vendimin e Komisionit udhëtimi në fjalë), dhe për subjektin A. D., i cili rezultoi se është pyetur në lidhje me faktin që nuk ka deklaruar pronarin e saktë, por ka deklaruar si pronar shtetasin N. P.. Subjekti konstaton se në trupin gjykues që ka dhënë vendimin për subjektin A. D., kanë qenë komisionerët F. Sh. dhe O. K., të cilët kanë qenë dhe anëtarë të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e tij (F. Sh.– relatore). Subjekti pretendon se për një situatë identike, për të njëjtat problematika, këta komisionerë kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, duke ngritur pikëpyetje serioze mbi objektivitetin dhe paanshmërinë e Komisionit në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj subjektit.

62.1 Lidhur me sa parashtron subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se nuk qëndron konstatimi i Komisionit se deklarimi i subjektit për pronarin e automjetit bëhet i pabesueshëm në kushtet kur me të ka udhëtuar dhe një koleg, subjekt rivlerësi, i cili është pyetur dhe përgjigjur në lidhje me këtë fakt, të evidentuar dhe në vendimin e bërë publik. Trupi gjykues çmon se Komisioni, vlerësimin në rastin konkret duhet ta bënte në bazë të rrethanave dhe të fakteve që kishte në dispozicion nga hetimi në lidhje me subjektin në fjalë, dhe jo të prezumonte dijeninë e subjektit të rivlerësimit për pronarin e automjetit nga hetimi dhe konkluzionet e vendimit të Komisionit për një tjetër subjekt rivlerësi.

62.2 Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për objektivitetin dhe paanshmërinë e anëtarëve të trupit gjykues për shkak të trajtimit ndryshe të situatave të njëjta, përveç faktit se ato mbeten deklarative dhe të paprovuara, sillet në vëmendje dhe qëndrimi i Kolegjit se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e dudur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni¹⁶.

- 63** Trupi gjykues shqyrtoi dhe denoncimin e paraqitur në Kolegj nga shtetasi I. P., regjistruar me nr. {***} prot., datë 02.06.2023, i cili pretendon për veprime korruptive të subjektit të rivlerësimit lidhur me ekstradimin e shtetasit A. G. në Itali. Trupi gjykues vëren se çështja e ekstradimit të shtetasit A. G. është verifikuar nga Komisioni, i cili, pasi ka administruar praktikën e ekstradimit të këtij shtetasi, përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim ka konkluduar se nuk rezultuan veprime procedurale apo

¹⁶ Shih vendimin e Kolegjit nr. 35/2022 (JR), prg. 34.

ligjore që të vërtetonin të dhënat/dyshimet se subjekti ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme gjatë trajtimit të kësaj çështjeje¹⁷.

- 64 Në konkluzion, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin, se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Përdorimi i automjetit me targë {***}, vlerësohet se nuk është relevant në vlerësimin e kriterit të figurës, si dhe në vlerësimin përfundimtar të çështjes për subjektin e rivlerësimit.

D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 65 Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësive profesionale të tij, të kryer nga KLP-ja dhe në analizimin e fakteve të denoncuara nga publiku gjatë procesit të rivlerësimit. Komisioni, në përfundim të vlerësimit për kriterin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit ka konkluduar se, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në vendimin përfundimtar, Komisioni ka konstatuar problematika për 10 çështje penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.
- 66 Lidhur me konkluzionet e Komisionit për këto 10 çështje, si dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për secilën prej tyre, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
- 67 Për procedimin penal nr. {***}, datë 29.05.2014¹⁸, me të pandehur shtetasin A. G., rezulton se Komisioni ka konkluduar se ka pasur zvarritje të çështjes, pasi subjekti i rivlerësimit, brenda afatit 3-mujor të hetimeve, për një periudhë prej 2 muajsh e 17 ditësh, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, dhe më pas ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit me argumentin e vetëm të njoftimit të akteve të pandehurit.
- 68 Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se zgjatja e afatit të hetimeve vetëm për njohjen e të pandehurit me aktet nuk është objektivisht e justifikueshme. Subjekti parashtron se ka sqaruar në Komision se, si shkak për zgjatjen e afatit të hetimeve me tre muaj, ka qenë së pari, ngarkesa në punë dhe së dyti, fakti që i pandehuri nuk ka dhënë një adresë të saktë për njoftimin e tij për kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse.

¹⁷ Në vendim, Komisioni ka evidentuar se: “nga shqyrtimi i akteve, ka rezultuar se: (i) me kërkesën e datës 5.3.2015, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë ka kërkuar ekstradimin e shtetasit A. G.; (ii) me kërkesën e datës 27.4.2015, të prokurorit Julian Xhengo, dërguar më 28.4.2015, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është kërkuar lejimi i ekstradimit të shtetasit A. G. për në Republikën e Italisë; (iii) me vendimin nr. {***} akti, datë 12.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorit, lejimi i ekstradimit të shtetasit A. G. nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, i akuzuar për veprën penale “Plagosje me pasojë vdekjen”. Në këtë vendim, ndër të tjera, është arsyetuar se kërkesa për ekstradim është në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara ligjore.

¹⁸ Një nga pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016.

- 69 Në vlerësim të pretendimeve të subjektit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të “Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt”, në ngarkim të shtetasit A. G., është bërë nga subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes, në datën 29.05.2014. Në datën 28.08.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit, nga data 28.08.2014 deri në datën 28.09.2014, me qëllim njohjen e të pandehurit me aktet dhe mbylljen e hetimeve. I pandehuri është njohur me aktet në datën 15.09.2014, sipas procesverbalit për njohjen me materialet e dosjes. Gjatë kësaj periudhe, të vetmet veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit janë aktet/veprimet procedurale, si kërkesa për vlerësimin e arrestimit në flagrancë drejtuar gjykatës, e datës 30.05.2014, vendimi për vlerësimin e sekuestros, datë 30.05.2014, si dhe urdhri për kthimin e sendit të sekuestruar, i datës 24.06.2014. Në vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë argument se përse është vendosur zgjatja e afatit, që do të mund të përligjte pretendimin e tij se shkak ka qenë se i pandehuri nuk ka dhënë adresë të saktë. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se qëndron konkluzioni i Komisionit për zgjatje të pajustificuar të afateve të hetimit dhe moskryerje në kohë të veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit.
- 70 Për procedimin penal/praktikën nr. {***}, me kallëzuese shtetasen V. Q.¹⁹, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i pabazuar konstatimi i Komisionit për mosrespektimin e afatit 30-ditor të regjistrimit të procedimit penal nr. {***}, të përcaktuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas subjektit, për këtë vonesë, shkak ka qenë ngarkesa në punë, për të cilën ka dhënë argumente në prapësimet përfundimtare dhe në seancë dëgjimore, por ky argumentim nuk rezulton të jetë përfshirë në vendimin e Komisionit.
- 71 Shtetasja V. Q. i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me ankesë, administruar në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun me nr. {***}, më datë 25.04.2016, në të cilën pretendon për pabazueshmërinë e qëndrimit të prokurorit Julian Xhengo, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F. Ç., akuzuar për veprën penale të “Mashttrimin”, me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë i Kodit Penal, si dhe tërheqjen e akteve në ngarkim të tij.
- 72 Lidhur me këtë procedim penal, Komisioni ka konkluduar se: *Subjekti ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë, prej 7 muajsh e gjysmë, pa arsye ligjore, ndërkohë që në bazë të udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh dhe afati i regjistrimit të procedimit është maksimumi 30 ditë. Pas regjistrimit të procedimit, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë mbi 7 muaj. Pas urdhërimit të Prokurorit të Përgjithshëm, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë mbi 3 muaj, për të cilat subjekti nuk dha sqarime konkrete, duke treguar kështu një mënyrë pune joefektive, që nuk pajtohet me pozicionin e tij. Këto shkelje janë të përsëritura nga subjekti i rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.*

¹⁹ Një nga praktikat e trajtuara nga Prokuroria e Përgjithshme, në bazë ankese të ankuses V. Q..

- 73 Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në vendimin e Komisionit nuk janë përfshirë argumentet e tij për këtë çështje. Pavarësisht se Komisioni në vendim nuk ka pasqyruar në detaje parashtrimet e subjektit lidhur me ngarkesën në punë, si dhe statistikat e sjella prej tij në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, në paragrafin 90.6 është përmendur se: *Në parashtrimet e veta, subjekti ka sqaruar si vijon: Në lidhje me konstatimin për mosrespektimin e afatit 30-ditor të përcaktuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti pretendon se ka ndodhur për shkak të mbingarkesës në punë në atë periudhë. Sa u takon konstatimeve në pikat (ii) dhe (iii), subjekti nuk dha sqarime konkrete dhe të qarta. Në parashtrimet e tij, subjekti dha sqarime të shumta sa i takon pretendimit të denoncueses për pabazueshmërinë e qëndrimit të prokurorit, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F. Ç.. Ai pretendon se qëndrimi i mbajtur prej tij në veprimet e kryera për zbardhjen e rrethanave të kësaj çështjeje penale, është i drejtë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti dosjen e procedimit penal nr. {***}, procesverbale të seancave gjyqësore, shkresë, datë 13.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkëlidhur vendimin e formës së prerë nr. {***} akti, datë 22.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të së cilës është vendosur rrëzimi i kërkesës së znj. V. Q. ndaj vendimit të pushimit të çështjes penale nr. {***}.*
- 74 Për sa u përket prapësimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj konkluzionit të Komisionit për vonesat në regjistrimin e procedimit penal dhe të kryerjes së veprimeve hetimore, nga verifikimi i akteve konstatohet se materiali kallëzues është përcjellë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, më datë 10.02.2014. Urdhri për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të mashtrimit, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, është nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit në datën 25.09.2014, pas 7 muajsh e gjysmë, duke tejkaluar afatin 30-ditor të parashikuar nga udhëzimi nr. 241/2005 i Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”.
- 75 Subjekti në ankim sqaron se pavarësisht udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, Kodi i Procedurës Penale në nenin 291, në periudhën në fjalë, nuk përcaktonte ndonjë afat kohor brenda të cilit prokurori duhet të fillonte mosfillimin e hetimeve apo regjistrimin e procedimeve. Lidhur me sa parashtron subjekti, trupi gjykues vëren se udhëzimi nr. 241/2005 i Prokurorit të Përgjithshëm ka dalë në mbështetje të neneve 287 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim për të normuar regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, si dhe për të shmangur praktikën e gabuara dhe për të vendosur rregulla të njëjta për të gjitha prokuroritë e shkallës së parë. Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe vendosja e afateve për regjistrimin e procedimeve dhe marrjen e vendimeve për mosfillim, dhe duke qenë se ky udhëzim ka qenë në fuqi në kohën kur është trajtuar procedimi penal në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ta zbatonte atë. Gjithashtu, bazuar në nenin 24, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale, në kohën kur është trajtuar kjo çështje, urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë kanë qenë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

- 76 Për sa u përket veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit pas regjistrimit të procedimit penal, konstatohet nga aktet se: (i) më datë 09.12.2014, nga oficeri i policisë gjyqësore (në vijim “OPGj”), është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi i cili tregon rrethana të hetimit; (ii) më datë 11.12.2014, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve, në prani të shtetases V. Q.; (iii) më datë 26.01.2015, është mbajtur nga OPGj-ja, procesverbal për marrjen e dokumenteve; (iv) sipas procesverbaleve të datave 15.01.2015, 20.01.2015, 17.02.2015, janë pyetur nga OPGj-ja dhe janë marrë të dhëna nga persona që tregojnë rrethana të hetimit. Më datë 23.09.2015, subjekti ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale. Nga veprimet e mësipërme hetimore, trupi gjykues konstaton se qëndron konkluzioni i Komisionit se pas regjistrimit të procedimit, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë mbi 7 muaj, pasi rezulton se pas datës 17.02.2015 dhe deri më datë 23.09.2015, nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor nga subjekti.
- 77 Me vendimin e datës 20.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. {***} në ngarkim të të pandehurit F. Ç.. Gjatë gjykimit të çështjes, në konkluzionet përfundimtare të dhëna në seancën e datës 22.04.2016, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar tërheqjen e akuzës dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit F. Ç. me argumentin se kjo çështje është gjykuar nga gjykata në një proces civil. Ky qëndrim i subjektit është vlerësuar i gabuar nga Prokuroria e Përgjithshme e cila mbi ankimin e shtetases V. Q. , me shkresën nr. {***}, datë 24.06.2016, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë që procedimi penal në ngarkim të të pandehurit F. Ç. të paraqitet sa më parë për gjykim. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 11.07.2016, ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve për procedimin penal nr. {***}, me arsyetimin se pas kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme për dërgimin e çështjes përsëri për gjykim, duhej bërë njohja e të pandehurit me aktet si dhe kryerja e veprimeve të tjera të nevojshme për mbylljen e hetimeve. Në datën 10.10.2016, subjekti i rivlerësimit, për nevoja të zbardhjes së rrethanave të hetimit për këtë procedim penal, ka mbajtur procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e provave materiale, sipas të cilit është administruar nga avokati i të pandehurit F. Ç., vërtetimi nga Alpha Bank, nga i cili rezulton se është transferuar në llogarinë e shtetases V. Q. në këtë bankë, shuma prej 10.000 eurosh. Sipas njoftimit noterial të noteres E. T., të datës 05.10.2016, ky veprim është kryer me qëllim shuarjen e detyrimit monetar të shtetasit F. Ç. ndaj shtetases V. Q.. Në vazhdim, me vendimin e datës 11.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Subjekti ka paraqitur në Komision, në kuadër të prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, vendimin nr. {***}, datë 22.05.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkuese V. Q., e cila ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes penale nr. {***}. Referuar këtij vendimi, gjykata e ka vlerësuar si të drejtë vendimin e subjektit të rivlerësimit të datës 11.10.2016 për pushimin e kësaj çështjeje penale, dhe ka rrëzuar kërkesën e kërkueses si të pabazuar në ligj dhe në prova.
- 78 Në përfundim, për këtë procedim penal, trupi gjykues vlerëson se qëndrojnë konstatimet e Komisionit për regjistrimin me vonesë të procedimit penal dhe për moskryerjen në kohë të

veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit. Por trupi gjykues vëren se pavarësisht zgjatjes së afatit të hetimeve për një periudhë 4-mujore, gjykata nuk ka konstatuar mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore, duke konfirmuar në këtë mënyrë qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit, në raport me hetimin e kryer prej tij.

- 79 Për sa u përket dy denoncimeve të paraqitura nga shtetasi B. K., lidhur me procedimin penal nr. {***}, Komisioni, në konkluzion, ka vlerësuar se pavarësisht natyrës së çështjes dhe volumit të dokumenteve të administruara, këto rrethana nuk justifikojnë periudhat e gjata të mosveprimeve nga subjekti, të konstatuara nga Komisioni. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se në trajtimin e çështjes objekt verifikimi, subjekti ka pasur: (i) tejkalim dhe, për pasojë, zvarritje në regjistrimin e procedimit penal, pa shkaqe të justifikuara; (ii) pavarësisht se subjekti nuk ka regjistruar emrat e personave që u atribuohet vepra penale deri në datën 1.12.2013, moment nga i cili do të fillonte afati i hetimeve sipas parashikimit të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, vlerësohet se ka zvarritje të hetimeve, pasi për periudha kohore relativisht të gjata, pa shkaqe ligjore, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor; (iii) ka mosmarrje të një vendimi në lidhje me memon e paraqitur nga një prej të pandehurve. Këto shkelje janë të përsëritura nga subjekti i rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes. Veç këtyre, në rastin konkret, ka pasur zvarritje të procesit gjyqësor për shkak të mosparaqitjes së subjektit në seanca gjyqësore, pa shkaqe ligjore dhe/ose pa arsye të justifikuara objektivisht dhe ligjërisht.
- 80 Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se konstatimet e Komisionit janë të pabazuara pasi nuk ka mbajtur në konsideratë natyrën e çështjes, volumin e dokumentacionit të administruar, si dhe faktin që në përfundim të hetimeve, është vendosur dërgimi për gjykim i 15 të pandehurve dhe se kryerja e veprimeve procedurale për secilin prej tyre ka kërkuar kohën e nevojshme. Subjekti kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ka qenë në kushtet e një konflikti në dukje të interesit gjatë trajtimit të çështjes objekt denoncimi, pasi nga rrethanat objektive të çështjes dhe qëndrimit të mbajtur gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes, ai nuk ka qenë në kushtet e konfliktit.
- 81 Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton se Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, më datë 12.01.2011, ka paraqitur materialin referues të veprës penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”. Pas regjistrimit të kallëzimit penal më datë 12.01.2011, nga subjekti i rivlerësimit janë kryer disa veprime, si: sekuestrimi i provave materiale në {***}, si dhe është kërkuar dokumentacion nga {***}-i. Në datën 31.03.2011, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Vjedhjes së kryer duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, pas më shumë se dy muajve nga data e regjistrimit të kallëzimit penal, ndërkohë që sipas udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, në pikën 2.1 përcaktohet se për vlerësimin e regjistrimit të procedimit penal, kërkohet kryerja e një minimumi verifikimesh nga ana e prokurorit, brenda një periudhe maksimumi deri në 30 ditë. Subjekti pretendon se regjistrimi me vonesë ka ardhur si pasojë e ngarkesës në punë, por ky argument nuk mund të shërbejë si justifikim për mospërbushjen e detyrave funksionale prej tij.

82 Pas regjistrimit të procedimit penal, subjekti në datën 27.10.2011, ka marrë vendim për këqyrjen e qendrës së sistemit të faturimit (Billing System) në zyrat qendrore të {***}-it. Ky është veprimi i parë dhe i vetëm hetimor i kryer nga subjekti pas gati gjashtë muajsh nga data e regjistrimit të procedimit, më datë 31.03.2011. Në periudhën nga data 28.04.2013 deri në datën 10.05.2013, nga ana e OPGj-së së Drejtorisë së Policisë, janë pyetur persona që tregojnë rrethana të dobishme për qëllime të hetimit. Regjistrimi i emrave të personave që u atribuohet vepra penale, është bërë nga subjekti më datë 01.12.2013. Nga rrethanat e mësipërme, rezulton se subjekti për periudha relativisht të gjata dhe pa shkaqe ligjore, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Trupi gjykues vëren se pavarësisht natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, referuar periudhave të mësipërme të mosveprimit, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ngarkesën në punë, nuk justifikon zvarritjen e hetimeve.

83 Subjekti kundërshton dhe konkluzionin e Komisionit në lidhje me memon e paraqitur nga palët më datë 25.4.2014, për të cilën subjekti duhet të kishte marrë një vendim. Sipas subjektit, në asnjë nga nenet e Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet ndonjë pavlefshmëri e akteve procedurale nga fakti i mosmarrjes së vendimit në lidhje me memon. Po ashtu, edhe gjykata nuk ka konstatuar pavlefshmëri të akteve për shkak të memos.

83.1 Nga verifikimi i akteve të Komisionit, rezulton se më datë 25.04.2014, avokati i një prej të pandehurve i ka paraqitur subjektit të rivlerësimit një memo me të cilën ka kërkuar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, si dhe zgjatjen e hetimeve për shkak të kompleksitetit të çështjes. Nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur vendimmarrje lidhur me memon e mësipërme.

83.2 Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se në nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: *1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.* Kjo dispozitë parashikon detyrimin e prokurorit të çështjes që të shprehet me vendim lidhur me memot dhe kërkesat e palëve, detyrim që në rastin konkret nuk është përmbushur nga subjekti i rivlerësimit. Ndryshe nga sa parashtron subjekti i rivlerësimit, Komisioni është shprehur vetëm për mosveprimin e prokurorit për marrjen e një vendimi dhe jo për vlefshmërinë ose jo të akteve procedurale, apo ndonjë pasoje tjetër të ardhur nga fakti i mosmarrjes së vendimit lidhur me memon. Për këtë arsye, trupi gjykues konstaton se janë të pabazuara pretendimet dhe argumentet që sjell subjekti për mospërmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

84 Sa i takon mosparaqitjes në disa seanca gjyqësore të lidhura me këtë çështje penale, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga procesverbalet e seancave që ai i ka vënë në dispozicion Komisionit, rezulton se ai ka njoftuar rregullisht gjykatën në të gjitha rastet që e bënin të pamundur paraqitjen e tij në seancë, për shkak të qenies i gatshëm apo të përfaqësimit të prokurorisë në seancat për vlerësimin e masave të sigurisë.

- 85 Lidhur me këto pretendime, nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të ndodhura në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se nga 67 seanca gjyqësore të zhvilluara për këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në 23 prej tyre. Nga numri total i seancave, rezulton se 9 seanca, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka qenë prezent, nuk janë zhvilluar dhe janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues, 7 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së dëshmitarëve dhe 3 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së avokatëve. Lidhur me mosprezencën e subjektit të rivlerësimit në seancat gjyqësore, rezulton se në 6 seanca, subjekti nuk ka bërë njoftim verbal apo me shkrim për mospjesëmarrje; në 16 seanca gjyqësore ka njoftuar verbalisht për mungesat kryesuesen e trupit gjykues ose sekretarinë e gjykatës, si vijon: në 10 seanca për mungesë për shkak të ndjekjes së masave të sigurimit personal dhe kërkesave për ekstradim, në 2 seanca për mungesë për shkak të lejes së zakonshme, dhe në 4 seanca për mungesë për arsye shëndetësore (të tij dhe të babait). Subjekti i rivlerësimit, me përjashtim të kërkesës me shkrim në gjykatë për mosprezencë në seancën e datës 30.01.2017, pasi nuk ka mundur të lexojë CD-në, në asnjë rast tjetër nuk ka justifikuar në Komision me akte shkresore shkaqet e pretenduara prej tij për mosparaqitjen në seancat gjyqësore. Ndërsa gjatë shqyrtimit të çështjes së tij në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, bashkë me parashtrimet para seancës gjyqësore, paraqiti dhe kopje të vendimeve gjyqësore me të cilat tentoi të justifikojë mosprezencën në një pjesë të seancave (në tetë seanca), për shkak të proceseve të tjera gjyqësore që zhvilloheshin në të njëjtën ditë (masa sigurimi, ekstradime), akte të cilat nuk u administruan nga Kolegji, sepse u paraqitën jashtë afateve ligjore. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se pavarësisht pretendimeve të subjektit se ka njoftuar rregullisht gjykatën, njoftim që nuk evidentohet për të gjitha seancat, vetëm fakti i njoftimit të gjykatës nuk mund të përbëjë një justifikim të arsyeshëm për të legjitimuar mosprezencën e prokurorit dhe rrjedhimisht, shtyrjen e seancave dhe zgjatjen e procesit gjyqësor.
- 86 Në përfundim, lidhur me këtë procedim penal, trupi gjykues vëren se janë të bazuara konkluzionet e Komisionit pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar kërkesat e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për afatin e regjistrimit të procedimit penal, kërkesat e nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale për marrjen e një vendimi për kërkesat e palëve, si dhe ka zvarritur hetimet, pasi për periudha kohore relativisht të gjata, pa shkaqe ligjore dhe objektive, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Gjithashtu, subjekti nuk ka justifikuar me akte shkresore shkaqet e pretenduara prej tij për mosparaqitjen në seancat gjyqësore të zhvilluara/programuara për këtë procedim penal, duke sjellë si pasojë zvarritje të pajustificuara të procesit gjyqësor.
- 87 Për sa u përket marrëdhënieve të subjektit të rivlerësimit me një nga dëshmitarët në çështjen penale në fjalë, Komisioni ka konkluduar se sipas nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, i cili i referohet nenit 17 të këtij Kodi, subjekti ka pasur për detyrë të heqë dorë për shkak se kanë ekzistuar shkaqe të rëndësishme njëanshmërie. Sipas Komisionit, subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit për shkak të lidhjes gjinore me një nga dëshmitarët e çështjes, dhe qenia në kushtet e këtij lloji konflikti interesi nuk kërkon domosdoshmërisht ardhjen e ndonjë pasoje. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e një konflikti në dukje të interesit gjatë trajtimit të çështjes objekt denoncimi të shtetasit B. K., fakt që është mbajtur në

konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale të subjektit, në drejtim të etikës profesionale.

- 88 Trupi gjykues vëren se, sipas vendimit objekt shqyrtimi, Komisioni ka arritur në këtë konkluzion pasi iu referua fakteve dhe rrethanave si vijojnë.
- Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 20.01.2015, rezulton se: *Gjykata, mbas konsultimit në vend, pyet prokurorin nëse ke shkak njëanshmërie. Prokurori: Nuk kam shkak njëanshmërie, por në kushtet kur ka një pretendim të tillë nga ana e avokatit, unë kërkoj ndërprerjen e seancës për t'u konsultuar me eprorët.*
 - Sipas procesverbalit të datës 22.09.2016, prokurori Julian Xhengo është pyetur nga gjykata nëse dëshmitari D. Xh. është pyetur si dëshmitar gjatë hetimeve paraprake nga ana e tij. Prokurori ka deklaruar se nuk e ka kërkuar këtë dëshmitar dhe se do të verifikojë fashikullin e hetimeve, pasi është voluminoz. Në këtë seancë, gjykata i ka lënë si detyrë prokurorit të verifikojë nëse ky dëshmitar është pyetur.
 - Në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në datën 17.10.2016, dëshmitari D. Xh., ndër të tjera, ka deklaruar: *Kam qenë drejtues i faturimeve në kompaninë {***}, jam marrë në vitin 2010 në pyetje nga prokuroria, nuk kam punuar në kohën kur ka ardhur prokuroria në ndërmarrje, unë nuk kam shkruar në gazetën "{***}", nuk jam proceduar nga prokuroria për sa kam qenë aty. Në muajin shkurt jam larguar, kam dhënë dorëheqjen në vitin 2011. Në këtë seancë, një nga të pandehurit e ka pyetur dëshmitarin nëse ka lidhje me prokurorin e çështjes dhe ai ka deklaruar se: *Kemi lidhje, e kam kushëri të largët, por këtu po e njoh.**
 - Në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në datën 01.11.2016, i pandehuri B. K. ka kundërshtuar prezencën e prokurorit të çështjes, duke u shprehur se është i paligjshëm.
 - Në sistemin e gjendjes civile, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. Xh. kanë atësi të ndryshme. Dy prindërit e tyre kanë gjithashtu atësi të ndryshme, çka nënkupton se ata nuk janë vëllezër.
- 89 Subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron se në aspektin formal, Komisioni ka të provuar vetëm faktin që ai me shtetasin D. Xh. kanë mbiemër të përbashkët dhe që baballarët nuk kanë të njëjtën atësi, dhe nuk ka asnjë provë tjetër nga e cila të rezultojë lidhja me këtë shtetas. Subjekti gjatë seancës dëgjimore në Komision, ka dhënë shpjegime me detaje në lidhje me marrëdhëniet e tij me shtetasin D. Xh. , duke deklaruar se baballarët e tyre janë djem xhaxhallarësh, por që nuk janë takuar asnjëherë më parë, përveç seancave gjyqësore për çështjen penale në fjalë.
- 90 Në vlerësimin e trupit gjykues, në kushtet kur nuk rezulton e provuar një njohje e mëparshme e subjektit të rivlerësimit me një nga dëshmitarët e çështjes, i cili rezulton të jetë një person me lidhje jo të afërt gjinore me subjektin, vetëm kjo marrëdhënie nuk përmbush kriteret për t'u vlerësuar si "konflikt interesi në dukje" apo si "shkak i rëndësishëm njëanshmërie", raste këto për të cilat subjekti i rivlerësimit do të duhej të deklaronte heqjen dorë nga çështja penale. Trupi gjykues vlerëson se përcaktuese për heqjen dorë të prokurorit, është nëse do të rezultonin dyshime objektive për paanësi mjaftueshmërisht të bazuara, si dhe rastet e parashikuara në nenet 17 dhe 26

të Kodit të Procedurës Penale. Vetëm rrethana e lidhjes së largët gjinore me një nga dëshmitarët nuk vërteton faktin se subjekti i rivlerësimit ishte në kushtet e heqjes dorë për këtë çështje, ndërkohë që nuk rezulton asnjë indicie tjetër që subjekti, duke ushtruar funksionin e prokurorit, të mos ketë ofruar garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim.

- 91 Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë shkak njëanshmërie në qëndrimin dhe veprimet e kryera prej tij në hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të kësaj çështjeje e, për pasojë, nuk ka pasur detyrim ligjor për të hequr dorë nga çështja penale në kuadër të parashikimeve të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, referuar nenit 17 të këtij Kodi, duke mos u gjendur në kushtet e konfliktit në dukje të interesit apo të ndonjë shkakut përjashtimi.
- 92 Në përfundim, për këtë procedim penal, trupi gjykues vlerëson, sikurse Komisioni, se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore për periudha kohore relativisht të gjata që kanë sjellë zvarritje të hetimeve, si dhe nuk është paraqitur në disa seanca gjyqësore duke sjellë tejzgjatje të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Por, ndërkohë, trupi gjykues vlerëson se gjatë trajtimit të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit nuk është ndodhur në kushtet e konfliktit në dukje të interesit.
- 93 Lidhur me denoncimin për procedimin penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji konstatimin e pabazueshmërisë së konkluzioneve të Komisionit se ka pasur zvarritje për shkak të regjistrimit tej afatit të këtij procedimi, si dhe se ka vendosur pushimin e hetimit pa kryer hetime të plota. Sipas subjektit, pushimi i hetimeve për këtë procedim penal, është vendosur bazuar në nenin 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi për të njëjtin fakt ishte regjistruar një procedim penal tjetër (nr. {***}) dhe çështja ishte dërguar për gjykim.
- 94 Komisioni, bazuar në denoncimin e shtetasit H. Sh., ka konkluduar se për procedimin penal nr. {***}, ka pasur zvarritje për shkak të regjistrimit të tij tej afatit, si dhe se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve 9 muaj pas regjistrimit, pa kryer hetime të plota të drejtuara prej tij dhe pa shkaqe ligjore. Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.
- 95 Subjekti në ankim parashtron se pasi është regjistruar procedimi penal, në datën 06.01.2016, është përpiluar prej tij urdhri për delegimin e veprimeve hetimore dhe detyrat që duhet të kryente oficeri i policisë gjyqësore, ku përfshihen edhe pyetja e shtetasve D. Sh. e K. Sh.. Oficeri i policisë gjyqësore ka kërkuar të pyesë shtetasit në fjalë, por urdhrat për paraqitjen e tyre janë kthyer në prokurori, me shënimin “Nuk u gjend” nga ftuesi i prokurorisë. Më pas, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, subjekti është vënë në dijeni se, për të njëjtin fakt penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë kishte regjistruar procedimin penal nr. {***} dhe se hetimet për këtë procedim penal, kishin përfunduar dhe çështja ishte dërguar për gjykim. Ky fakt rezulton nga procesverbali i këqyrjes e marrjes së provave materiale i datës 25.07.2016. Për sa më sipër,

subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, bazuar në nenin 328/1 (f) të Kodit të Procedurës Penale. Sipas subjektit, nëse do të bënte hetime të tjera për një çështje e cila ishte hetuar dhe dërguar për gjykim, do të cenohej parimi i gjësë së gjykuar.

- 96 Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues vëren se:
- Më datë 02.06.2015, është administruar materiali kallëzues i referuar nga Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë, për veprën penale të “Shkatërrimit të pronës”, pasi, sipas kallëzuesit H. Sh., shtetasit K. Sh. dhe D. Sh., në datën 29.05.2015, i kanë korrur grurin në tokën e tij. Ky material kallëzues i është caktuar për trajtim subjektit të rivlerësimit nga drejtuesi i prokurorisë në datën 04.06.2015.
 - Më datë 31.12.2015, subjekti, si prokuror i çështjes, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.
 - Më datë 06.01.2016, subjekti ka urdhëruar delegimin e veprimeve hetimore OPGj-së E. Ll., për kryerjen e disa veprimeve hetimore, si: saktësimi i pronësisë së tokës, pyetja e shtetasve K. Sh. dhe D. Sh., në cilësinë e personave që kanë dijeni mbi rrethanat e hetimit deri më datë 10.03.2016 dhe identifikimi, nëse është e mundur, i personave të tjerë që mund të deklarojnë fakte në lidhje me sa pretendohet në kallëzimin penal.
 - Në datat 11.02.2016 dhe 21.03.2016, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar paraqitjen e shtetasve K. Sh. dhe D. Sh., për të cilët është mbajtur shënimi: *U kërkua, nuk u gjet.*
 - Në datën 14.07.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së procesverbalit të pyetjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasit K. Sh., datë 29.05.2016, të mbajtur nga OPGj-ja L. F., me arsyetimin se shtetasi K. Sh. nuk ka qenë i regjistruar me këtë cilësi në regjistrin e njoftimeve të veprave penale nga prokurori, veprim që është atribut i prokurorit, dhe jo i OPGj-së.
 - Më datë 25.07.2016, janë marrë kopje të akteve të procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, hetuar nga prokurori E. Gj., nga ku ka rezultuar se më datë 02.06.2015, është administruar materiali kallëzues i referuar nga Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë, në lidhje me ngjarjen e ndodhur më datë 26.05.2015, që, sipas kallëzuesit H. Sh., shtetasit K. Sh. dhe D. Sh. i kanë shkatërruar grurin në tokën e tij. Në lidhje me këtë procedim penal, pas kryerjes së veprimeve hetimore, më datë 23.06.2016 është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim në ngarkim të shtetasit D. Sh. për veprën penale të vetëgjyqësisë.
 - Më datë 02.09.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, duke arsyetuar ndër të tjera se nga verifikimi në sekretarinë e prokurorisë, rezulton se për të njëjtin fakt, kallëzimin e paraqitur nga shtetasi H. Sh. për korrjen e grurit në tokën e tij, është regjistruar procedimi penal nr. {***} dhe, në përfundim, është dërguar për gjykim i pandehuri D. Sh..
- 97 Nga aktet e mësipërme, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka regjistruar procedimin penal pa autor, tej afatit 30-ditor, gati 7 muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal. Për sa u përket veprimeve të kryera nga subjekti për hetimin e çështjes, rezulton se për periudhën 31.12.2015 - 02.09.2016, veprimi i vetëm hetimor i kryer rezulton të jetë urdhërimi i paraqitjes së shtetasve K.

Sh. dhe D. Sh. për t'u pyetur në lidhje me pretendimet e ngritura në kallëzim, marrje në pyetje e cila nuk është arritur të realizohet dhe nuk është shoqëruar me veprime të mëtejshme hetimore të subjektit.

- 98 Lidhur me shkaqet të cilat kanë çuar subjektin e rivlerësimit në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, trupi gjykues konstaton se nga krahasimi i të dhënave nga dosja e çështjes tjetër penale nr. {***}, në materialin kallëzues, si dhe në aktet e tjera të prokurorit për çështjen nr. {***}, referohen vetëm ngjarjet e datës 26.05.2015 dhe kallëzimi nuk është bërë ndaj shtetasit K. Sh.. Ndërsa në materialin kallëzues të çështjes objekt shqyrtimi, referohen ngjarje të datës 29.05.2015 dhe kallëzimi penal është bërë ndaj dy shtetasve, K. Sh. dhe D. Sh.. Trupi gjykues vëren se pavarësisht që kallëzimi penal për të dyja çështjet është bërë nga i njëjti person, konstatohet se bëhet fjalë për dy ngjarje të ndodhura në ditë të ndryshme, ndonëse duken me të njëjtën anë objektive dhe të kryera afër njëra-tjetrës, me të pandehur të ndryshëm, dhe nuk qëndrojnë argumentet e subjektit të rivlerësimit se është e njëjta ngjarje e cila përbën të njëjtin fakt penal, dhe se për këtë arsye duhej vendosur pushimi i procedimit penal.
- 99 Sa më sipër, në përfundim, për këtë procedim penal, trupi gjykues konkludon se janë të bazuara konstatimet e Komisionit për zvarritje nga ana e subjektit të rivlerësimit, të regjistrimit të procedimit penal nr. {***}, si dhe për marrjen e vendimit për pushimin e hetimeve për këtë procedim penal pa shkaqe ligjore dhe pa kryer hetime të plota, edhe pse vendimi i pushimit të hetimeve të procedimit penal nuk është ankimuar në gjykatë.
- 100 Për denoncimin e paraqitur në Komision nga shtetasi M. P., subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se janë marrë dy vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve pa i arsyetuar ato. Sipas subjektit, këto vendime janë marrë në kushtet e mbingarkesës në punë dhe gjykata nuk ka konstatuar ndonjë pavlefshmëri të zgjatjes së hetimeve, duke vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit M. P..
- 101 Komisioni në vendim ka vlerësuar se në këtë çështje, ka pasur zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, për shkak të shtyrjes dy herë të afatit të hetimeve për shkaqe jo të justifikuara sipas parashikimeve të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas Komisionit, këto janë shkelje të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.
- 102 Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues vëren se: (i) me urdhrin, datë 29.10.2014, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***} për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”, në ngarkim të shtetasit M. P.; (ii) me vendimin e datës 29.1.2015, subjekti ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për një periudhë tremujore, nga data 29.1.2015 deri më 29.4.2015, me argumentin se *shtetasi M. P. ka mohuar të ketë ndërhyrë në sistemin e matjes së energjisë. Ai ka pretenduar se në aparatit matës të energjisë elektrike, mund të ketë ndërhyrë dikush tjetër. Për sa më sipër, meqë është e nevojshme kryerja e veprimeve për verifikimin e pretendimeve të të pandehurit, është e nevojshme zgjatja e afatit të hetimeve për këtë*

procedim penal; (iii) me vendimin e datës 29.4.2015, subjekti ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për një periudhë tremujore, nga data 29.04.2015 deri më 29.7.2015, me argumentin identik si vendimi i mëparshëm; (iv) me vendimin e datës 29.7.2015, subjekti ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor për një periudhë tremujore, nga data 29.7.2015 deri më 29.10.2015, me të njëjtin argument si dy vendimet e mëparshme.

103 Po nga aktet, trupi gjykues konstaton se në periudhat midis vendimeve të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore si rezultat i të cilave do të justifikohesh/argumentohesh vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve. Sipas nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale: *Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur.* Në këtë rast, për nga natyra e procedimit penal, nuk vërtetohet kompleksiteti i çështjes dhe as pamundësia objektive për përfundimin e hetimeve brenda afatit të zgjatjes. Trupi gjykues vlerëson se, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, mosankimi nga i pandehuri i vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve, nuk legjitimon mosveprimet e prokurorit që kanë sjellë si pasojë zvarritjen e hetimeve për këtë çështje penale, pasi zbatimi i afateve procedurale është një detyrim që duhet zbatuar, dhe që lidhet me garantimin e parimit të sigurisë juridike dhe hetimit efektiv, pavarësisht ushtrimit të së drejtës së ankimit nga palët në proces. Në përfundim, për sa më sipër, për këtë procedim penal, trupi gjykues vlerëson se konstatimet e Komisionit për zvarritje të afateve të hetimit, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

104 Lidhur me denoncimin e paraqitur nga shtetasi A. Ç., Komisioni ka konkluduar se ka pasur zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, për shkak se regjistrimi i procedimit penal është bërë tre muaj pas regjistrimit të kallëzimit penal. Pas regjistrimit të procedimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë kohore prej 1 viti e 8 muajsh, pa dhënë shkaqe ligjore. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk dha sqarime të plota dhe nuk paraqiti dokument shkresor për të vërtetuar se ka përcjellë në gjykatë fashikullin e çështjes, dhe se në dosje nuk rezulton të jetë dokumentuar marrja dijëni nga i pandehuri për kërkesën për gjykim, sipas parashikimit në nenin 331/3 të Kodit të Procedurës Penale: *Kërkesa u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit.*

105 Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, për këtë procedim penal, nga aktet në fashikullin e Komisionit, konstatohet se: (i) më datë 16.09.2014, sipas urdhrorit të zv/drejtuesit të prokurorisë, subjekti ka marrë për trajtim materialin kallëzues nr. {***}, datë 02.09.2014, me kallëzuese shtetasen A. Ç.; (ii) më datë 30.09.2014, është pyetur shtetasja A. Ç., e cila ka deklaruar se me bashkëshortin është në proces divorci, ka kërkuar të pajiset me urdhër mbrojtjeje dhe se nuk ka bërë kallëzim për ndjekje penale. Kjo shtetase ka paraqitur në gjykatë aktin mjeko-ligjor nr. {***}, dt. 27.01.2014, për urdhër mbrojtjeje për dhunën e ushtruar nga bashkëshorti dhe, duke qenë se më pas nuk ka pasur probleme, ka kërkuar që ai të mos ndiqet penalisht; (ii) më datë 19.12.2014, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, pa autor, dhe kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGj-ja, ndërsa

më datë 02.09.2016, ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, shtetasin A. Ç., për veprën penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal; (iv) më datë 31.10.2016, subjekti ka vendosur njoftimin e akuzës shtetasit A. Ç., për veprën penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal; (v) më datë 07.11.2016, janë mbajtur procesverbale nga OPGj-ja, për pyetjen e të pandehurit A. Ç. dhe për njohjen me aktet; (vi) më datë 07.11.2016, subjekti ka vendosur dërgimin e çështjes penale për gjykim, si dhe ka kërkuar gjykimin e çështjes penale në gjykatë.

- 106** Lidhur me konstatimin e Komisionit për regjistrimin me vonesë të procedimit penal, subjekti parashtron në ankimin drejtuar Kolegjit, se kallëzuesja nuk ka kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale dhe se vepra penale për të cilën ishte regjistruar ky kallëzim, ndiqej kryesisht. Në vlerësim të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, së pari konstatohet nga aktet se kallëzimi penal është përcjellë në prokurori në datën 02.09.2014 ndërsa regjistrimi i procedimit penal është bërë më 19.12.2014, pas më shumë se tre muajsh, në kundërshtim me afatin 30-ditor të përcaktuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” të Prokurorit të Përgjithshëm. Pavarësisht se kallëzuesja nuk ka kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale, duke qenë se bëhet fjalë për vepra penale që ndiqen kryesisht, siç e thekson dhe vetë subjekti, ai si prokuror i çështjes, brenda afatit 30-ditor duhet të kryente verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë apo nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, dhe më pas të vendoste për regjistrimin e procedimit penal. Ky afat është përcaktuar në udhëzimin e mësipërm për çdo hetim të veprave penale, pa specifikuar nëse bëhet fjalë për vepra në bazë kallëzimi apo të ndjekura kryesisht. Trupi gjykues vëren se pavarësisht specifikës së këtij procedimi penal për shkak të marrëdhënieve familjare që ekzistonin midis së dëmtuarës dhe të pandehurit, si dhe qëndrimit të së dëmtuarës për të mos paraqitur kallëzim për ndjekje penale, mbeten të pabazuara argumentet e subjektit të rivlerësimit për vonesën e regjistrimit të procedimit penal.
- 107** Subjekti, për këtë procedim penal, kundërshton konstatimin e Komisionit se nuk është dokumentuar marrja dijeni nga i pandehuri për kërkesën për gjykim, duke prapësuar se të pandehurit i është njoftuar akuza dhe është njohur me të drejtat e tij në cilësinë e personit të pandehur kundrejt nënshkrimit, si dhe me të drejtën për të zgjedhur vetë mbrojtës apo për të kërkuar një të tillë nga organi procedues, por ai nuk ka zgjedhur vetë dhe nuk ka kërkuar nga organi procedues që t’i caktohej mbrojtës.
- 108** Sa u takon këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren se nga aktet, rezulton që me vendimin e datës 31.10.2016, “Për njoftimin e akuzës shtetasit A. Ç.”, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit shtetasin A. Ç., duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të dhunës në familje, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 1 i Kodit Penal. Në këtë dokument gjendet dhe firma e të pandehurit A. Ç., i cili ka bërë dhe një shënim, sipas të cilit kundërshton akuzën si të stisur dhe kërkon të bëhet një hetim i thellë i çështjes. Sipas procesverbalit të datës 07.11.2016, i pandehuri ka deklaruar se është njohur me cilësinë me të cilën është marrë në pyetje dhe ka

deklaruar se nuk është dakord me akuzën. Nga aktet në fashikuj, rezulton dhe vendimi i subjektit për dërgimin e çështjes penale për gjykim, i datës 07.11.2016. Në këtë dokument, subjekti i rivlerësimit është shprehur se mbrojtësi i të pandehurit është njohur me aktet hetimore. Po në këtë datë, subjekti ka nënshkruar kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për gjykimin e çështjes penale nr. {***}, për të pandehurin A. Ç.. Nuk ka në dosje asnjë akt që të vërtetojë njoftimin dhe marrjen dijani të të pandehurit, ose të mbrojtësit të tij, për dërgimin e kërkesës për gjykim, veprim që duhet të ishte kryer nga prokurori bazuar në nenin 331, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale (*para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017*), që parashikonte se: “Kërkesa u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”.

- 109** Për sa i përket dokumentimit të dërgimit të fashikullit të hetimeve në gjykatë, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se kjo çështje penale është përcjellë nga prokuroria në gjykatë për gjykim, kundrejt shkresës përcjellëse të nënshkruar nga drejtuesi i prokurorisë, por nuk ka arritur dot ta dokumentojë në përgjigje të rezultateve të hetimit, pasi me gjithë kërkesën drejtuar gjykatës, nuk i është vënë në dispozicion fashikulli i gjykimin të kësaj çështjeje. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit, si dhe qëndrimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se edhe pse nuk rezulton të ketë një shkresë përcjellëse të drejtuesit të prokurorisë për dërgimin e çështjes për gjykim në fashikullin e Komisionit, është evident fakti që dosja është përcjellë për gjykim në gjykatë, me vendim të së cilës i pandehuri është deklaruar fajtor dhe është dënuar.
- 110** Në përfundim të sa konstatuar më sipër, trupi gjykues konkludon se për këtë procedim penal qëndrojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit vetëm për sa i përket dërgimit në gjykatë të kërkesës për gjykimin e këtij procedimi, dhe mbeten të bazuara konstatimet e Komisionit për regjistrimin me vonesë të procedimit penal, si dhe për mosnjoftimin e kërkesës për gjykim të pandehurit.
- 111** Në Komision ka paraqitur denoncim shtetasi K. G., i cili ka pretenduar, midis të tjerave, dhe shkelje të afateve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, sa u takon procedimeve penale nr. {***}, nr. {***} dhe nr. {***}. Denoncuesi ka qenë në cilësinë e të pandehurit në dy prej këtyre çështjeve penale.
- 112** Komisioni, në përfundim të vlerësimit të këtij denoncimi, ka vënë re se në trajtimin e procedimit penal nr. {***}, konstatohen disa periudha kohore relativisht të gjata pa kryer veprime hetimore në mënyrë të vijueshme, si dhe ka pasur zgjatje të hetimeve pa shkaqe legjitime, të cilat kanë çuar në zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion pasi ka evidentuar këto problematika: (i) Pretendimi sipas të cilit, pas regjistrimit të procedimit penal nr. 1340, datë 22.2.2017, deri më 20.6.2017, ka kryer veprime hetimore, me argumentin se në datën 17.5.2017, u ka dërguar autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkesë për ndihmë juridike, është i pabazuar, pasi kjo letërporosi është dërguar në kuadër të procedimit tjetër, nr. {***}. (ii) Subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për periudha kohore prej 9, 5, 4 dhe 3 muajsh, afate të cilat nuk mund të justifikohen me ngarkesën në punë apo volumin e dokumentacionit, sidomos në kushtet kur subjekti në mënyrë të përsëritur rezulton të ketë pasur tejkalime të afateve

që kanë çuar në zvarritje të hetimeve. Pretendimit se janë kryer disa veprime hetimore, të cilat ndodhen në dosjen penale nr. {***} dhe për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor, nuk mund t'ia vërë në dispozicion të Komisionit, vlerësohen si një justifikim nga ana e subjektit, pasi ai nuk ka bërë asnjë përpjekje për të vërtetuar se veprimet hetimore të kryera përbëjnë sekret hetimor. Po kështu, pretendimi i subjektit që veprimet hetimore i kanë kaluar çështjes nr. {***}, e cila u vërtetua të jetë në shqyrtim e sipër, mbeten në nivel deklarativ. (iii) Në lidhje me konstatimin se pas regjistrimit të emrave të personave nën hetim, nuk ka kryer veprime hetimore, subjekti ka sqaruar në lidhje me disa veprime të kryera prej tij, por nuk i ka vërtetuar veprimet hetimore të pretenduara, po me të njëjtin arsyetim se veprimet e dokumentuara ndodhen në dosjen e procedimit penal nr. {***}. (iv) Sa i takon vendimit të tretë të zgjatjes së afatit të hetimeve, rezulton se në datën 27.4.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur ndarjen e procedimit penal, në procedimin me nr. {***}, në ngarkim të shtetasve I. B. dhe R. S., duke arsyetuar se për këta shtetas kanë përfunduar hetimet, si dhe në atë me nr. {***}, në ngarkim të shtetasit K. G. etj., me arsyetimin se për këta shtetas është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore. Në datat 11/12.5.2021, ka njoftuar shtetasit I. B. dhe R. S. për përfundimin e hetimeve të procedimit nr. {***}. Pra, siç shihet, edhe pas përfundimit të hetimeve të këtij procedimi, subjekti sërish në datën 22.6.2021, vendos zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. {***}, deri më 22.9.2021, me të njëjtin argument si dy vendimet e mëparshme, pa kryer veprime hetimore. Në këto kushte, sipas Komisionit, zgjatja e afateve të hetimit vlerësohet e pajustificuar objektivisht dhe ligjërisht, bazuar në kërkesat e nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

- 113** Lidhur me procedimet penale objekt denoncimi, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton se: (i) në datën 22.02.2017, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasve I. B. dhe R. S., për veprat penale të "Mashtimit me pasoja të rënda të kryer në bashkëpunim" dhe të "Shpërdorimit të detyrës"; (ii) në datën 03.05.2017, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, për veprat penale të "Falsifikimit të dokumenteve" dhe të "Fshehjes së të ardhurave"; (iii) Prokuroria Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasve I. B. dhe R. S., për veprat penale të "Mashtimit me pasoja të rënda të kryer në bashkëpunim" dhe të "Shpërdorimit të detyrës"; (iv) me vendimin e datës 20.06.2017, është vendosur bashkimi i dy procedimeve penale nr. {***} dhe nr. {***} në një procedim të vetëm, nr. {***}, me argumentin se këto dy procedime janë regjistruar për disa vepra të pretenduara të kryera nga i njëjti shtetas; (v) në datën 08.05.2019, subjekti ka vendosur bashkimin e procedimeve nr. {***} dhe {***}; (vi) me shkresën nr. {***}, datë 17.05.2017, u është dërguar autoriteteve gjyqësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkesë për ndihmë juridike (letërporosi), për pyetjen e shtetasit E. P. në lidhje me faktin nëse konfirmon apo jo vërtetësinë e faturave për shërbime të kryera ndaj shoqërisë "{***}" ShA; (vii) me vendimin e datës 27.04.2021, është vendosur ndarja e çështjes penale nr. {***} në dy procedime penale: procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të I. B., i dyshuar si autor i veprës penale të "Mashtimit me pasoja të rënda të kryer në bashkëpunim", të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, si dhe të R. S., e dyshuar si autore e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; dhe

procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasve K. G., D. D., N. K., Q. H., A. D., S. M. dhe personit juridik "{***}" ShA.

- 114** Subjekti prapëson në ankim konstatimin e Komisionit se pas regjistrimit të procedimit penal nr. {***}, datë 22.2.2017, deri më datë 20.6.2017, nuk ka kryer veprime hetimore, dhe se letërporosia është dërguar në kuadër të procedimit nr. {***}. Sipas subjektit, procedimi penal nr. {***} është bashkuar me procedimin penal nr. {***}, datë 03.05.2017, me vendimin e bashkimit të procedimeve penale të datës 20.06.2017. Të dyja këto procedime kanë pasur objekt kryesor të hetimeve faktin nëse janë ose jo të falsifikuara faturat e lëshuara nga shoqëria "{***}" për shërbime të kryera ndaj shoqërisë "{***}" ShA. Trupi gjykues vëren se nga sa paraqet subjekti, si dhe për sa rezulton nga aktet, konstatohet se për gjithë periudhën, nga regjistrimi i procedimit penal nr. {***}, në datën 22.2.2017, dhe deri në datën 20.06.2017, kur ky procedim është bashkuar me procedimin tjetër nr. {***}, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, dhe dërgimi i letërporosisë është kryer për qëllime të procedimit tjetër, nr. {***}. Edhe nëse do të pranohej argumenti i sjellë nga subjekti se të dyja procedimet kishin të njëjtin objekt hetimesh dhe se letërporosia është dërguar në funksion të të dyja procedimeve, mbetet përsëri fakti që subjekti deri në datën 03.05.2017, të regjistrimit të procedimit tjetër, për një periudhë gati 2 muaj e gjysmë nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për procedimin e parë.
- 115** Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për periudha kohore prej 9, 5, 4 dhe 3 muajsh, afate të cilat nuk mund të justifikohen me ngarkesën në punë apo volumin e dokumentacionit, sidomos në kushtet kur subjekti në mënyrë të përsëritur rezulton të ketë pasur tejkalime të afateve që kanë çuar në zvarritje të hetimeve, subjekti prapëson në ankim se gjatë periudhës 2017-2019, janë kryer veprime hetimore për administrimin e një sasive voluminoze dokumentacioni nga organet tatimore dhe gjykatat, si dhe nga përfaqësuesit e shoqërive që kanë lëshuar fatura. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se me shkresën nr. {***}, datë 17.05.2017, u është dërguar autoriteteve gjyqësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës një kërkesë për ndihmë juridike (letërporosi), me qëllim për të konfirmuar vërtetësinë e disa faturave. Subjekti sqaron se pa ardhur përgjigjja e letërporosisë dhe pa u konfirmuar fakti nëse faturat kanë qenë ose jo të falsifikuara, nuk mund të kryheshin veprime të tjera hetimore. Vetëm pasi ka ardhur konfirmimi i faktit që faturat kanë qenë të falsifikuara, nga ana e subjektit është proceduar më tej me kryerjen e veprimeve hetimore për zbardhjen e rrethanave.
- 116** Trupi gjykues konstaton nga aktet se, nga data 22.2.2017, kur është bërë regjistrimi i procedimit të parë penal, nr. {***}, subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë këto veprime hetimore:
- a. Në kuadër të procedimit penal nr. {***}, më datë 04.05.2017: (i) është kërkuar informacion dhe kërkesë për vënie në dispozicion aktesh nga {***} (në vijim "{***}"); (ii) është kërkuar nga "{***}" ShA informacion i detajuar në lidhje me aktin e auditimit të deklaratave të llogarisë të lidhura me shoqërinë "{***}" ShA; (iii) subjekti ka vendosur sekuestrimin e provave materiale pranë shoqërisë "{***}" ShA; (iv) më datë 03.10.2017, është kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë nëse shoqëria "{***}" ShA ka deklaruar fatura të lëshuara nga

shoqëria “{***}”; (v) në datën 04.04.2018, është kërkuar përsëri informacion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, lidhur me kontrollet e kryera ndaj shoqërisë “{***}” ShA.

b. Në kuadër të procedimit penal nr. {***}: (i) në datën 16.03.2018, i është kërkuar informacion dhe kërkesë për vënie në dispozicion aktesh nga {***}-ja ; (ii) në datën 13.06.2018, subjekti, në kuadër të procedimit penal nr. {***}, i ka kërkuar informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me marrëveshjet ndërmjet shoqërisë “{***}” ShA dhe “{***}”; (iii) në datën 11.11.2018, subjekti ka marrë vendim për këqyrjen dhe marrjen e akteve pranë {***}-së dhe institucioneve të tjera në lidhje me shoqërinë “{***}” ShA.

c. Nga data 22.09.2020, e regjistrimit të emrave të personave nën hetim dhe deri në përfundim të afatit 3-mujor të hetimeve paraprake, datë 22.12.2020, është kërkuar informacion në {***} (datë 16.11.2020), si dhe janë pyetur shtetasit R. S. (datë 09.11.2020) dhe I. B. (datë 17.12.2020). Këto dy veprime të fundit hetimore nuk janë konstatuar nga Komisioni në raportin e rezultateve të hetimit, si dhe në vendimin objekt shqyrtimi.

ç. Më datë 11.05.2021, subjekti ka njoftuar personin nën hetim I. B., dhe më datë 12.05.2021, subjekti ka njoftuar personin nën hetim R. S., për përfundimin e hetimeve.

117 Trupi gjykues vëren nga datat e veprimeve të mësipërme hetimore se, pavarësisht evidentimit të kryerjes dhe të disa veprimeve të tjera hetimore që nuk janë konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit për periudha disamujore nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

118 Po nga aktet, trupi gjykues konstaton se në datën 22.12.2020, subjekti ka vendosur zgjatjen me tre muaj të afatit të hetimit të procedimit penal nr. {***}, me arsyetimin: *Rezulton se duhen kryer veprime hetimore të mëtejshme të nevojshme (një pjesë e veprimeve hetimore që duhen kryer janë kërkuar të kryhen nga shtetasi K. G., ndërsa veprime të tjera duhen kryer në varësi të rezultateve të veprimeve të kryera)*, pra pa përcaktuar se cilat veprime konkrete janë të nevojshme të kryhen. Më datë 22.03.2021, subjekti ka vendosur përsëri zgjatjen me tre muaj të afatit të hetimit të procedimit penal nr. {***}, me të njëjtin arsyetim si në vendimin e mëparshëm. Nga aktet nuk konstatohen veprime hetimore për periudhën nga 22.12.2020 deri më datë 22.03.2021. Më datë 22.06.2021, subjekti ka vendosur për herë të tretë zgjatjen me tre muaj të afatit të hetimit të procedimit penal nr. {***}, me të njëjtin arsyetim si në dy vendimet e mëparshme. Nga aktet, nuk konstatohen veprime hetimore për periudhën nga data 22.03.2021 deri në datën 22.06.2021.

119 Rezulton se në të tria këto vendime të marra nga subjekti, të cilat në përmbajtje janë identike dhe ndryshojnë vetëm datat, nuk ka pasur asnjë të dhënë për veprimet e kryera aktualisht për çdo fazë/tremujor, rrethanat që kanë sjellë si pasojë nevojën për zgjatjen e afateve të hetimit si dhe përcaktim të veprimeve konkrete që duhen ndërmarrë në kuadër të vazhdimin të hetimit. Si rezultat, për një periudhë 9-mujore, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me procedimin penal nr. {***}. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon kryerjen e disa veprimeve hetimore për këtë periudhë, por për shkak të mospasjes në dispozicion të akteve të fashikullit nr. {***}, që ka rezultuar pas ndarjes së çështjeve më datë 27.04.2021, si

një çështje që është akoma nën hetim, nuk mund të verifikohet vërtetësia e këtyre pretendimeve, veçanërisht për periudhën pas kësaj date.

120 Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit i cili ka vlerësuar si një justifikim të subjektit mosvënien në dispozicion të akteve të cilat ndodhen në dosjen penale nr. {***}, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Komisioni ka konstatuar se veprimet hetimore i përkisnin çështjes nr. {***}, e cila ishte mbyllur në datën 21.9.2021, kur subjekti ka kërkuar pushimin e këtij procedimi penal, dhe pretendimi i subjektit që veprimet hetimore i kanë kaluar çështjes nr. {***}, e cila u vërtetua të jetë në shqyrtim e sipër, mbeten në nivel deklarativ. Sipas subjektit, aktet e procedimit penal nr. {***} të vitit 2021, sipas neneve 279/1 dhe 287/3 të Kodit të Procedurës Penale, përbëjnë sekret hetimor përderisa kjo çështje vazhdon të jetë në hetim, fakt që vërtetohet dhe nga shkresa nr. {***}, datë 07.09.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

120.1 Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se faktikisht Komisioni u referohet veprimeve hetimore të kryera nga subjekti në kuadër të çështjes nr. {***}, të regjistruar në datë 22.02.2017 dhe për të cilën subjekti ka vendosur pushimin më datë 21.09.2021. Nga fashikujt, rezulton se Komisioni ka pasur në dispozicion aktet e procedimit penal {***}, që u korrespondojnë fashikujve 12/6 - 12/15, sipas inventarit të dosjes së subjektit të rivlerësimit, dhe mbi bazën e dokumentacionit që ka disponuar nga këta fashikuj, ka arritur në konkluzionet lidhur me veprimet hetimore të kryera nga subjekti. Prandaj mbetet i pabazuar dhe i paprovuar pretendimi i subjektit se ka kryer dhe veprime të tjera hetimore për periudhën 20.06.2017 - 22.09.2020, pasi këto veprime nuk dokumentohen në fashikujt që datojnë deri në datën 21.09.2021, datë që i përket mbylljes së çështjes nr. {***}, e cila nuk ka qenë e ruajtur nga sekretit hetimor.

121 Në përfundim, nga analiza e akteve dhe rrethanave më sipër, për procedimin penal nr. {***}, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë edhe rrethanat e kësaj çështjeje shumë komplekse, hetimi për të cilën shtrihet në dy shtete, si dhe kohën për dërgimin dhe marrjen e letërporosive dhe kryerjen e veprimeve juridike, në kuadër të kërkesës për ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të ShBA-së, vlerëson se qëndrojnë pjesërisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit për arsyet e zgjatjes së hetimeve, si dhe për kryerjen edhe të disa veprimeve hetimore të cilat nuk janë evidentuar saktë nga Komisioni. Gjithsesi, trupi gjykues vëren se mbeten të bazuara konstatimet e Komisionit për periudha kohore relativisht të gjata pa u kryer veprime hetimore nga subjekti, si dhe për zgjatje të pajustificuara objektivisht dhe ligjërisht të afatit të hetimeve, bazuar në kërkesat e nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

122 Në Komision ka paraqitur denoncim shtetasi Q. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, i cili ka kundërshtuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, nga subjekti i rivlerësimit. Lidhur me denoncimin e këtij shtetasi, Komisioni në përfundim ka konkluduar se: (i) subjekti ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë, tej afatit 30-ditor, pa arsye të legjitimuara dhe të justifikuara; (ii) nga regjistrimi i procedimit dhe deri në pushimin e tij, datë 1.9.2014, vërehen periudha prej 3 muajsh pa kryer veprime hetimore, si dhe pa kryer verifikime të plota për pretendimet e ngritura në kallëzim, ashtu siç u konstatua nga vendimi i drejtorit të Drejtorisë së

Hetimit të Krimin Ekonomik Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme; (iii) subjekti nuk shprehet me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga palët, sikurse parashikon neni 110 i Kodit të Procedurës Penale: *1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.*

- 123** Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara konkluzionet e Komisionit pasi çështjet e kësaj natyre, në të cilat ka pretendime për veprimtarinë e funksionarëve shtetërorë apo çështje të natyrës së krimin ekonomik e shtetëror, nuk mund të trajtohen dhe analizohen thjesht në mënyrë mekanike nëse veprimet hetimore janë apo jo të njëtrajtshme në shpërndarje në kohë, për vetë specifikën e tyre. Subjekti parashtron se hetimet prej tij janë kryer të plota, duke administruar gjithë dokumentacionin, duke marrë informacion nga organet e administratës shtetërore dhe duke kryer ekspertimin përkatës. Vendimi për pushimin e hetimeve i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata ka lënë në fuqi këtë vendim.
- 124** Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, konkretisht, dosja e procedimit penal nr. {***} të vitit 2013, trupi gjykues vëren se:
- Më datë 12.7.2013, është regjistruar kallëzimi penal nr. {***}, datë 12.07.2013, i shtetasit Q. B.. Nga zv/drejtuesi i prokurorisë, në datën 22.07.2013, i është kaluar për trajtim kallëzimi penal prokurorit Julian Xhengo, me shënimin: “Prokurori është me leje”.
 - Më datë 14.10.2013, shtetasi Q. B. ka paraqitur një memo, me anë të së cilës ka kërkuar vlerësim real të investimeve në hidrocentralin “{***}”.
 - Më datë 22.11.2013, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe delegimin e veprimeve hetimore OPGj-së E. K.. Po në këtë datë, është lëshuar nga subjekti urdhri për delegimin e veprimeve hetimore, ku janë përcaktuar dhe veprimet që duhen kryer²⁰.
 - Më datë 10.03.2014, është administruar memoja nr. 2 e kallëzuesit, i cili kërkon të njihet me dokumentacionin e certifikimit të investimeve.

²⁰ Pas regjistrimit të procedimit penal, rezultojnë të jenë kryer këto veprime hetimore: (i) sipas procesverbalit për marrjen e dokumenteve, më datë 13.12.2013, janë marrë dokumentet nga shtetasi B. Z., drejtor i Drejtorisë Hidro-Energjetike në {***}; (ii) në datën 19.03.2014, i është dërguar kërkesë për informacion dhe dokumentacion {***}-së. Pas kthimit përgjigjes nga {***}-ja për mosdisponim të dokumentacionit origjinal, është përsëritur kërkesa më datë 18.04.2014, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën që disponohet nga {***}-ja, duke tërhequr vëmendjen se vonesa në përgjigje ka sjellë pengesa në hetimin e procedimit penal; (iii) në datat 30.04.2014, 03.06.2014 dhe 27.06.2014, nga prokuroria i është kërkuar informacion dhe dokumentacion në mënyrë të përsëritur Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, e cila ka përcjellë informacionin e kërkuar më datë 17.07.2014; (iv) më datë 08.07.2014, sipas procesverbalit, është pyetur si person që ka dijeni për veprën penale, shtetasi P. I., si dhe është kryer marrja e dokumenteve nga ky shtetas, administrator i shoqërisë “{***}” ShPK; (v) në datat 09.10.2013, 23.10.2013, 12.11.2013, rezultojnë të jenë pyetur persona që kanë dijeni për veprën penale, konkretisht shtetasit P. S., K. J., B. Z., punonjës të {***}-së.

d. Pas relacionit të OPGj-së E. K., të datës 15.07.2014, ku sugjerohet pushimi i çështjes, subjekti, më datë 01.09.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}, duke parashtruar rrethanat e faktet dhe referimin e provave në lidhje me pretendimet e shtetasit Q. B., mbi investimet e kryera në HEC-in Tuçep, mbi veprimet e punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si dhe mbi pretendimet për moslikuidim nga shoqëria “{***}” ShPK për energjinë e shitur, pretendim që hyn në juridiksionin civil, duke konkluduar se bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

dh. Pas ankimit të kallëzuesit Q. B. mbi pushimin e procedimit penal, drejtori i Drejtorisë së Hetimit të Krimit Ekonomik Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme, më datë 18.11.2014, ka vendosur: 1) Shfuqizimin e vendimit të datës 11.07.2013, “Për pushimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”. 2) Urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të kryejë veprimet e nevojshme hetimore për këtë procedim penal, duke lënë dhe detyrat për plotësimin e hetimeve.

e. Pas shfuqizimit të vendimit, datë 01.09.2014, për pushimin penal nr. {***}, të administruar më datë 24.11.2014, nga ana e subjektit rezultojnë të jenë kryer disa veprime të tjera hetimore në funksion të plotësimit të hetimeve²¹.

ë. Subjekti i rivlerësimit në datën 23.04.2015 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}, duke parashtruar rrethanat e faktet dhe referimin në prova që kanë të bëjnë me veprimet për plotësimin e hetimit dhe në analizë të tyre, është shprehur se sa i takon pretendimit të shtetasit Q. B. për investime të pakryera në HEC-in Tuçep nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK dhe pretendimit për veprime korruptive nga ana e punonjësve të {***}-së dhe shtetasit P. I., mbeten të pabazuara. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se, bazuar në nenin 328/1/b të K. Penal, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

f. Nga aktet në të dhënat e raportit profesional të dërguar nga KLP-ja, rezultojnë se denoncuesi ka ushtruar ankim dhe vendimi i pushimit të subjektit të rivlerësimit është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor në të dyja shkallët, duke e lënë atë në fuqi.

125 Lidhur me konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, të kundërshtuara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjyqësor vëren se rezultojnë i bazuar konkluzioni se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal pas një kohe relativisht të gjatë, tej afatit 30-ditor, pa arsye të legjitimuara dhe të justifikuara. Nga data e regjistrimit të kallëzimit penal, 12.07.2013, deri në datën e regjistrimit të procedimit penal, 22.11.2013, kanë kaluar mbi 4 muaj, në kundërshtim me afatin 30-ditor të përcaktuar në udhëzimin nr. 241 të Prokurorit të Përgjithshëm. Mbeten të pabazuara pretendimet e subjektit se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga kallëzuesi ka qenë i konsiderueshëm, duke pasur në konsideratë se në këtë fazë procedurale nuk kërkohen veprime hetimore të detajuara për të vendosur për regjistrimin e procedimit nga ana e prokurorit të çështjes.

²¹ i) Marrja e dokumentacionit nga shtetasit Q. B., P. I., kompania “{***}”, E. J., Xh. T., E. H., procesverbale të procedimeve të tjera. ii) Është administruar aktekspertimi në lidhje me verifikimin e investimeve në terren për HEC-in Tuçep. iii) Janë marrë deklaratimet e punonjësve të {***}-së dhe {***}-s, janë marrë deklaratimet e personave që kanë kryer punimet nga shoqëritë “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK.

- 126 Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se nga regjistrimi i procedimit dhe deri në pushimin e tij në datën 01.09.2014 (për një periudhë mbi 9 muaj), nuk janë kryer veprime hetimore për perioda disamujore, si dhe nuk janë kryer verifikime të plota, trupi gjykues konstaton, në ndryshim nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime hetimore në këtë periudhë që i ka vlerësuar në funksion të hetimit, edhe pse nga vendimi i drejtorit të Drejtorisë së Hetimit të Krimet Ekonomik Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme, këto veprime nuk janë konsideruar të mjaftueshme, pasi *nuk është kryer një hetim i plotë në lidhje me gjithë pretendimet e kallëzuesit*. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për çështje të kësaj natyre, nuk mund të analizohet në mënyrë mekanike nëse veprimet hetimore janë apo jo të njëtrajtshme dhe të mjaftueshme, por ky argument i subjektit nuk justifikon moskryerjen e veprimeve hetimore, edhe pse regjistrimi i veprës penale është bërë pa autor.
- 127 Gjithashtu, trupi gjykues konstaton nga aktet në fashikuj, se subjekti nuk është shprehur me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga kallëzuesi, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale: *1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve*. Subjekti parashtron se çdo pretendim i kallëzuesit është trajtuar gjatë hetimit të çështjes dhe në arsyetimin e vendimit të pushimit, argument që, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk e justifikon mosveprimin e tij sipas detyrimit të përcaktuar në dispozitën e mësipërme.
- 128 Lidhur me këtë procedim penal, trupi gjykues konstaton nga aktet se denoncuesi ka ushtruar ankim ndaj vendimit të pushimit të hetimeve, të marrë nga subjekti i rivlerësimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***} akti, datë 28.12.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Q. B., pasi ka çmuar se nga ana e prokurorit, janë kryer veprimet e duhura hetimore dhe se gjykata nuk konstaton ndonjë veprim që nuk është kryer nga ana e prokurorit që, nëse do të kryhej, mund të çonte prokurorin në një konkluzion të ndryshëm nga ai që ka arritur. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 27.09.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- 129 Në përfundim, për procedimin penal të mësipërm, trupi gjykues, duke vërejtur se Komisioni ka konkluduar për problematika vetëm në drejtim të afateve hetimore, por jo në hetimin dhe zgjidhjen e çështjes, çmon se pavarësisht se në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit konstatohen mangësi si rezultat i mosveprimit në kohë për regjistrimin e procedimit penal, si dhe për kryerjen e hetimeve, nuk rezulton që veprimet hetimore të kryera prej subjektit të rivlerësimit të jenë të mangëta dhe të kenë sjellë pasoja për të drejtat e palëve në proces. Ky fakt evidentohet dhe nga verifikimi i vendimeve gjyqësore të dhëna lidhur me këtë procedim penal, në të cilat gjykatat nuk kanë konstatuar mangësi dhe të meta në veprimtarinë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit.
- 130 Denoncuesi E. L. ka denoncuar në Komision vendimin e mosfillimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit, sa i përket kallëzimit penal nr. {***}, pasi ka zvarritur procesin mbi tre muaj, si dhe

nuk ka kryer veprime hetimore për identifikimin e personit që e kishte kërcënuar në ambientet e gjykatës.

- 131** Për denoncimin e paraqitur nga ky shtetas, Komisioni në përfundim ka konkluduar se: *Vendimi i mosfillimit të procedimit, i marrë pas një kohe relativisht të gjatë, prej 4 muajsh, tej afatit prej 15 ditësh të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, është pa shkaqe ligjore dhe nuk justifikohet me ngarkesën në punë, pasi në këto raste kërkohet kryerja e një numri minimal veprimesh verifikuese. Sqarimet e subjektit se ka përpiluar shkresën përcjellëse për njoftimin e vendimit të mosfillimit të hetimeve në adresën që ky shtetas ka dhënë në kallëzimin penal, vlerësohen jo të plotë e të qarta, pasi në kallëzim, kallëzuesi ka paraqitur adresë të plotë, numër telefoni dhe adresë e-mail-i. Këto shkelje janë të përsëritura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes.*
- 132** Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se vendimi për mosfillimin e hetimeve është marrë tej afatit 15-ditor të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të mbingarkesës në punë. Subjekti i rivlerësimit prapëson në ankim se nuk qëndron konstatimi i Komisionit se është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin e akteve, pasi ai ka përpiluar shkresën përcjellëse për njoftimin e vendimit dhe procedura e mëtejshme e njoftimit është procedurë administrative dhe e shërbimit postar dhe se praktikisht është e pamundur për prokurorin që të kujdeset dhe të mbikëqyrë dërgimin e akteve.
- 133** Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit për sa u përket konstatimeve të Komisionit, lidhur me afatin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit, trupi gjykues konstaton nga aktet, se në datën 28.02.2019, është regjistruar kallëzimi penal i shtetasit E. L. ndaj të dyshuarit i panjohur, për kërcënim, përndjekje, shtrëngim për heqje dorë nga pronësia. Në datën 01.03.2019, nga drejtuesi i prokurorisë i është caktuar ky material kallëzues subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 12.06.2019, ka vendosur mosfillimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. {***}. Nga aktet sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka marrë vendimin e mosfillimit pas gati 4 muajsh nga regjistrimi i kallëzimit penal, në shkelje të afatit 15-ditor të përcaktuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: *Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.*
- 134** Për sa u përket konstatimeve të Komisionit lidhur me njoftimin e akteve, rezulton se në fashikullin e çështjes nr. {***}, ndodhet akti për dërgimin e vendimit të mosfillimit të hetimeve, dërguar denoncuesit, firmosur nga drejtuesja e prokurorisë, pa datë dhe numër protokolli. Nisur nga ky akt, duket se janë kryer veprimet për njoftimin e kallëzuesit, por nuk mund të konfirmohen data e dërgimit dhe marrja e njoftimit nga i interesuari. Sa më sipër, pavarësisht se akti i njoftimit për dërgimin e vendimit të mosfillimit nuk është i plotë, trupi gjykues vëren se mbetet i paprovuar edhe konkluzioni i Komisionit se ky njoftim nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit.

- 135 Shtetasja D. Xh. ka paraqitur në Komision një denoncim në lidhje me procedimin penal nr. {***}, me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin për kallëzimin e denoncueses ndaj OPGj-së O. Gj., për manipulim dhe falsifikim të provave për ngjarjen e aksidentit ku ka vdekur bashkëshorti i saj në vitin 2015.
- 136 Për denoncimin e paraqitur nga kjo shtetase, Komisioni ka konstatuar se nuk rezulton shkresa përcjellëse për njoftimin e vendimit të mosfillimit të hetimit për kallëzimin penal nr. {***}, si dhe nuk rezulton të jetë e dokumentuar marrja dijëni e këtij vendimi. Këto mosveprime të subjektit, të cilat kanë sjellë si pasojë mosushtrimin e së drejtës së ankimit në kohë ndaj këtij vendimi nga ana e kallëzueses dhe, si pasojë, tejzgjatjen e procesit të saj në dyert e drejtësisë, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale të subjektit. Gjithashtu, nga Komisioni vlerësohet se në këtë çështje, nga ana e subjektit, në vendimin e mosfillimit duhet të ishte kryer edhe verifikimi mbi praktikën e punonjësve të doganës.
- 137 Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se nga prokuroria nuk është verifikuar çdo pretendim i ngritur nga kallëzuesja në kallëzimin penal, pasi objekt i kallëzimit penal të paraqitur nga kjo shtetase, kanë qenë pretendime mbi veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore gjatë hetimit të rrethanave ku ka humbur jetën bashkëshorti i kallëzueses. Në fazën e verifikimit të pretendimeve të ngritura në një kallëzim penal, nuk ka hetim, por prokurori vendos regjistrimin e procedimit penal apo mosfillimin e hetimeve pasi vlerëson pretendimet e ngritura dhe çmon nëse duhet bërë ndonjë verifikim për këto pretendime. Subjekti prapëson dhe se nuk qëndron konstatimi i Komisionit, se është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin e akteve, pasi procedura e njoftimit është procedurë administrative dhe e shërbimit postar.
- 138 Lidhur me këtë procedim, nga aktet në fashikujt e Komisionit konstatohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 29.05.2018, ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***}, të referuar nga oficerët e policisë gjyqësore²². Me vendimin e datës 07.06.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. {***}, me arsyetimin se: *nga veprimet verifikuese të kryera, nuk ka prova që oficeri i policisë gjyqësore të ketë kryer veprime në kundërshtim me ligjin gjatë ushtrimit të detyrës [...] si dhe rezulton se shumë prej pretendimeve të kallëzueses nuk janë të bazuara*. Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***}, të datës 30.03.2021, është vendosur shfuqizimi i vendimit të prokurorisë dhe urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për hetimin e pretendimeve të kallëzueses se nga punonjës të administratës doganore, janë përpiluar praktika me të dhëna të rreme. Mbi bazën e këtij vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në datën 07.05.2021,

²² Në informacionin për referimin e veprës penale të prokurorit, referohet: “Shtetasja D. Xh. ka paraqitur një kallëzim penal ndaj oficerit të policisë O. Gj., për veprimet e kryera prej tij për dokumentimin e aksidentit të datës 16.10.2015, ku për pasojë ka humbur jetën bashkëshorti i saj”.

është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

- 139** Trupi gjykues konstaton nga aktet se nuk ka një njoftim të kallëzueses lidhur me vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit për mosfillimin e hetimeve. Në fashikullin e çështjes ka një shkresë dërgim njoftim vendimi, por pa numër protokollit, datë dhe pa nënshkrimin e drejtuesit të prokurorisë, dhe që nuk arrin të provojë pretendimin e subjektit se vendimi është njoftuar. Mospasja dijani e denoncueses konfirmohet dhe nga korrespondenca që ajo ka pasur me vetë subjektin e rivlerësimit në janar 2021, me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme (mars 2021), dhe me Prokurorinë Tiranë, e cila, pas kërkesës së datës 28.01.2021, me shkresën nr. {***}, datë 11.02.2021, njofton kallëzuesen se është vendosur mosfillimi, si dhe i ridërgon vendimin e datës 07.06.2018 për mosfillimin e hetimeve. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se nëse ankuesja nuk do të kishte marrë dijani, nuk do t’i ishte drejtuar gjykatës, por evident në këtë rast është fakti se denoncuesja ka marrë dijani për vendimin e mosfillimit më shumë se dy vite e gjysmë nga dalja e tij. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se mosveprimi i subjektit për mbikëqyrjen e njoftimit të kallëzueses mbi vendimin e mosfillimit të procedimit penal, ka sjellë si pasojë mosushtrimin e së drejtës së ankimit në kohë nga ana e kallëzueses dhe, si pasojë, tejzgjatjen e procesit të saj.
- 140** Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se nuk është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin e njoftimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje se sipas parashikimit të nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. Pavarësisht pretendimit se është sekretaria që kryen njoftimet, është detyrë e prokurorit që, në kuadër të njoftimit të palëve, të orientojë policinë gjyqësore dhe sekretarinë për kryerjen e veprimeve të nevojshme, për më tepër në kushtet kur në vendimin e prokurorit ai shprehet të njoftohen të interesuarit për këtë vendim. Ky detyrim i prokurorit vjen në interpretim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, nenit 134, pika 1, që përcakton se: *Njoftimi i akteve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar [...]*; nenit 24 të këtij Kodi që përcakton se prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod; dhe nenit 277, pika 2, që përcakton se: *Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.* Nga dispozitat e sipërcituara, rezulton se pavarësisht se detyrën e njoftimit të akteve të prokurorit, ligji ia ka ngarkuar oficerit të policisë gjyqësore, kontrolli i hetimeve paraprake dhe i kryerjes së detyrave nga policia gjyqësore, pjesë e të cilave janë edhe veprimet e njoftimit të akteve të prokurorit, kryhen nga prokurori. Sa më sipër, trupi gjykues nuk i vlerëson tërësisht të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim.
- 141** Për sa u përket kundërshtimeve të subjektit ndaj konkluzioneve të Komisionit, se nga ana e tij duhet të ishte kryer verifikimi i çdo pretendimi të ngritur në kallëzimin penal nr. {***}, rezulton

se një mangësi e tillë në veprimet hetimore është konstatuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, në vendimin nr. {***}, datë 30.03.2021, është shprehur se: [...] *jo të gjitha pretendimet e ngritura në kallëzim u janë nënshtruar procedurave ligjore verifikuese [...].*

- 142** Në përfundim, Kolegji arrin në përfundimin për këtë procedim penal, se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi nuk është realizuar njoftimi i vendimmarrjes së prokurorit, si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.
- 143** Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke analizuar dhe denoncimet për disa nga procedimet penale të mësipërme, trupi gjykues konstaton se:
- a. Subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin e çështjeve penale pasi në mënyrë të përsëritur:
 - i) regjistrimi i procedimit penal është kryer tej afateve ligjore, pa shkaqe të justifikuara ligjërisht;
 - ii) pas regjistrimit të procedimit penal, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka regjistruar emrat e personave që u atribuohet vepra penale, ka pasur zvarritje në kryerjen e hetimeve, pasi për periudha kohore relativisht të gjata dhe pa shkaqe të justifikuara, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor;
 - iii) ka zgjatur afatet e hetimeve pa shkaqe ligjore dhe me të njëjtin arsyetim të marrë nga vendimet e mëparshme, ndërkohë që nuk ka kryer asnjë veprim hetimor pas marrjes së këtyre vendimeve.
 - b. Subjekti i rivlerësimit në dy çështje penale nuk ka mbikëqyrur zbatimin e urdhërimit për njoftimin e palëve për vendimmarrjen, si dhe për akte të tjera procedurale, sipas parashikimeve të nenit 291, pika 2, dhe 331, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.
 - c. Në shqyrtimin e një çështjeje penale në gjykatë, subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues i organit të akuzës, nuk ka marrë pjesë në 20 seanca gjyqësore publike, pa vërtetuar/dokumentuar mospjesëmarrjen për shkaqe të justifikuara ligjërisht dhe objektivisht, si dhe duke shfaqur mangësi në drejtim të efektivitetit të ndjekjes së procesit gjyqësor.
 - ç. Në dy çështje penale, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur me vendim në lidhje me memot e paraqitura nga palët, sikurse parashikon neni 110 i Kodit të Procedurës Penale.
- 144** Trupi gjykues çmon se vonesat në veprimet e kryera që kanë ardhur si pasojë e ngarkesës në punë, tregojnë më së paku mangësi të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit për të përballuar ngarkesën në punë e për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të njoftimit, të cilat, bazuar në parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, maten duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet një çështjeje dhe kohën për marrjen e një vendimi përfundimtar për çështjen. Mangësitë e karakterit organizativ dhe të lidhura me mosveprimin me efikasitet kanë sjellë në mënyrë të përsëritur mospërmbushjen e disa prej detyrave të tij si prokuror, evidentuar veçanërisht në fazat e para të fillimit të një procedimi penal.

- 145** Trupi gjykues vëren se sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i rivlerësimit të aftësive profesionale është të identifikojë magjistratët që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Trupi gjykues, në përputhje me qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, dhe në mbështetje të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit²³, vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016.
- 146** Për sa analizuar dhe vlerësuar më lart, trupi gjykues, në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, krahas konfirmimit pjesërisht të mangësive të evidentuara nga Komisioni, në trajtimin e procedimeve nga subjekti i rivlerësimit, mban në konsideratë edhe ngarkesën reale në punë të subjektit, e cila jo vetëm gjatë periudhës së vlerësimit në 3 vitet e fundit nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016 (2013 – 2016), por gjatë gjithë harkut kohor 2014 – 2021, rezulton që të jetë për çdo vit mbi ngarkesën mesatare të prokurorisë ku subjekti ka ushtruar detyrën. Gjithashtu, është mbajtur në konsideratë edhe fakti i vështirësisë, kompleksitetit dhe ndjeshmërisë sociale të procedimeve penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe moskonstatimi i pavlefshmërisë së vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit që do të sillnin si pasojë pavlefshmëri të akteve dhe shmangie nga përgjegjësia penale të autorëve të veprave penale, të hetuar apo dërguar për gjykim. Trupi gjykues, në shqyrtimin e çështjeve penale të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk konstatoi asnjë rast të parashkrimit të afateve të ndjekjes penale, ushtrim të funksionit në kushtet e papajtueshmërisë apo shkelje të etikës në lidhje me palët në proces.
- 147** Mangësitë e konstatuara në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit janë kryesisht të natyrës së organizimit të punës dhe të veprimit me efikasitet në kryerjen e veprimeve procedurale, të cilat kanë afektuar indikatorin e aftësive organizative të parashikuar në nenin 74, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Në një vështrim harmonik të kriterëve/niveleve të vlerësimit të magjistratit sipas nenit 78 të këtij ligji, ku indikatorët e aftësive profesionale dhe të etikës e

²³ Vendimi nr. 28 (JR), datë 23.10.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 16: “Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vëren se shkeljet që duhen konsideruar për të bërë një vlerësim të plotë të këtij kriteri, lidhen me ato të konstatuara në lidhje me zbatimin e gabuar të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile dhe me zbatimin e gabuar të nenit 80 të Kodit Penal në çështjet e përshkruara më lart. Duke analizuar këto mangësi në raport me të gjitha çështjet e tjera të analizuara prej Komisionit, edhe në kuadër të verifikimit të denoncimeve, e duke pasur në konsideratë edhe raportin e hartuar për çështjet e përzgjedhura me short e të dorëzuara prej vetë subjektit, ngarkesën e tij të punës, vitet e gjata në karrierë, peshën e këtyre mangësive në zgjidhjet e çështjeve konkrete dhe pasojat e ardhura, Kolegji çmon se gjen vend të zbatohet standardi i përdorur nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj në paragrafin 54 të vendimit nr. 2/2017, sipas të cilit: “Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)””.

angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas neneve 73 e 75 të po këtij ligji, konsiderohen me peshë determinante, trupi gjykues konkludon se mangësitë e aftësive organizative të konstatuara në rastin e subjektit të rivlerësimit vlerësohen të pamjaftueshme për t'u konsideruar si shkak për shkarkimin e tij.

148 Në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas analizës së mësipërme të fakteve dhe interpretimit të ligjit të zbatueshëm, dhe në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet e Komisionit lidhur me çështjet penale dhe denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi, nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

149 Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të vendimit nr. 560, datë 14.09.2022, konfirmon gjetjet dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, mosdeklarimin e prindërve si persona të lidhur, konsiderimin në analizën financiare të vitit 2010 të të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit në vlerën 530.000 lekë, deklarimin e pasaktë të subjektit të rivlerësimit për vlerën reale të blerjes së automjetit në vitin 2016, si dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme, në vlerën prej 397.603 lekësh, deri në momentin e blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit, në datën 26.12.2016.

150 Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por në ndryshim nga Komisioni, çmon se përdorimi i automjetit me targë {***}, nuk është relevant në vlerësimin përfundimtar të çështjes për subjektin e rivlerësimit.

151 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit çmon se mangësitë e konstatuara nuk janë të një rëndësie të tillë sa të gjejë zbatim neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, por janë të një niveli të tillë që kualifikohet si nivel “me mangësi” i kriterit të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, dhe mund të plotësohen/shërohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda një viti. Në mbështetje të këtij konkluzioni, trupi gjykues vlerëson se ndaj subjektit të rivlerësimit duhet të jepet masa disiplinore e pezullimit nga detyra, e parashikuar në nenin 58, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

152 Në vlerësim të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, trupi gjykues çmon se aplikimi i pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 duhet të ndodhë për shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara prej nenit 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016. Cenimi i besimit të publikut te drejtësia, në

kuptim të kësaj dispozite, duhet të mbështetet në vlerësimin tërësor të tri kritereve të rivlerësimit apo në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të rivlerësimit në raport me sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi, e jo duke analizuar në mënyrë të veçantë vetëm njërin prej kritereve të rivlerësimit. Në këto kushte, në ndryshim nga qëndrimi i Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se rrethanat e mësipërme, të lidhura vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk mund të konsiderohen si elemente të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

153 Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues çmon se vendimi i Komisionit nr. 560, datë 14.09.2022, duhet ndryshuar pasi nuk gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin Ë, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 44, shkronja “b” dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 560, datë 14.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo.
2. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
3. Ky vendim ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 02.11.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, nuk isha dakord me vendimin e shumicës së trupit gjykues dhe votova për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Julian Xhengo. Në vlerësimin tim, problematikat e konstatuara në kontrollin e kriterit të vlerësimit profesional, nuk janë të një natyre që mund të shërohen nëpërmjet trajnimit njëvjeçar. Parë së bashku me problemet e konstatuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë, këto konstatime duhet të kishin passjellë konfirmimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për këtë subjekt. Arsyetimi mbi të cilin bazohet konkluzioni im, shtjellohet në vijim.

A. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

2. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka burime të ligjshme për një automjet të blerë në vitin 2016, të cilin e ka deklaruar të blerë thuajse sa gjysma e kostove të konfirmuara me dokumentacion, ka një balancë negative në analizën financiare dhe probleme në mosdeklarimin e prindërve në cilësinë e personave të lidhur në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [vetting]. Këto konkluzione kanë qenë pjesë e vlerësimit përfundimtar për cenim të besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ndryshe nga shumica, kam vlerësuar që këto gjetje, duke pasur parasysh edhe rrethanat faktike e ligjore mbi të cilat ato mbështeten, duhet të kishin passjellë lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, pasi subjekti nuk arriti në nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë, dhe të ishin pjesë integrale e vlerësimit të përgjithshëm për subjektin.
3. Me rrethanat faktike e ligjore, referuar më lart, mbaj në konsideratë faktin që së pari, subjekti është shkëputur nga trangu familjar në tetor 2016, pak muaj përpara se të plotësonte deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe pasi ishte miratuar kuadri ligjor për rivlerësimin. Përveç një konstatimi kalimtar për pasaktësi në deklaratën vetting, Komisioni nuk rezultoi t'i ketë dhënë peshën e pritshme këtij veprimi në kontekstin e sjelljes së subjektit në procesin e rivlerësimit, ndonëse ka konkluduar së është kryer pikërisht për t'iu shmangur deklaramit të pasurisë dhe që shpjegimet e parashtruara prej tij janë “të paqarta e jobindëse”²⁴. Komisioni ka konstatuar po ashtu se shpjegimet në seancë, në thelb u bazuan mbi rrethana të pavërteta. Konkretisht, subjekti ka pretenduar se ndarja nga trangu familjar në tetor 2016, ka qenë për shkak të celebrimit me bashkëshorten, fakt që rezultoi i pavërtetë pasi celebrimi ka ndodhur në korrik 2017, 10 muaj pasi ai është shkëputur nga trangu familjar. Fakti që pavërtetësia e këtij pretendimi është lehtësisht e verifikueshme nga aktet, reflekton një qasje të palogjikshme dhe haptazi në keqbesim të subjektit në procesin e rivlerësimit. Përpos këtij fakti, subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë ndër vite pasuritë e personave të lidhur pas vitit 2006, ndonëse në një certifikatë familjare, duke vështirësuar analizën e kryer nga organet e rivlerësimit. Sikurse edhe shumica, isha dakord me konsiderimin e prindërve

²⁴ Shih paragrafin 67.1 të vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim-Julian-Xhengo...pdf>.

të subjektit persona të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit. Ndryshe nga shumica, vlerësoj se veprimet e sipërreferuara, së bashku me sa shtjellohet edhe në vijim në drejtim të qasjes së subjektit, duhet të ishin mbajtur në konsideratë në drejtim të vlerësimit të tij të përgjithshëm, në funksion të perceptimit që përçojnë këto veprime në publik.

4. Së dyti, vlerësova me peshë dhe domethënëse në procesin e rivlerësimit, rrethanat që lidhen me vlerën e automjetit të blerë prej tij më 27 dhjetor 2016. Subjekti ka zgjedhur të deklarojë se ka shpenzuar vetëm vlerën e treguar në kontratë, 980.000 lekë, ndërkohë që nga aktet në fashikull, rezulton qartë që kostoja totale e shpenzuar nga shitësja, është minimalisht ekuivalenti i 1,8 milionë lekëve [shifër e rrumbullakosur], në harkun kohor nga 11 deri në 12 nëntor 2016, një muaj përpara tjetërsimit të këtij mjetei në favor të subjektit. Fakti që blerja e automjetit është dakordësuar nga palët disa ditë përpara blerjes së tij në Itali, dhe që blerësja ishte në një moshë të avancuar, tregon që shpjegimet e subjektit për shitje *nën vlerë* për shkaqe urgjence shëndetësore të shitëses, janë të pasinqerta. Duke shtuar edhe faktin që subjekti, pavarësisht përfshirjes së gjithë burimeve të mundshme, rezulton me pamundësi financiare për afërsisht $\frac{1}{4}$ e vlerës së automjetit sipas akteve, përbën konstatim me peshë në vlerësimin tim të sjelljes së subjektit të rivlerësimit, sidomos nëse konsiderohet në kontekstin e konstatimeve të tjera të Komisionit, për automjete të blera më lirë sesa vlera me të cilën janë shitur²⁵.
5. Pavarësisht nga ky fakt, ndonëse neni 33, pika 5 përmban edhe germën “c” – deklarin e rremë – Komisioni është kufizuar duke e quajtur deklarin e vlerës së kësaj pasurie në thujse $\frac{1}{2}$ e saj si *pasaktësi*, përpos konkluzionit për mungesë burimesh. Nën dritën e gjithë sa më sipër, vlerësova që problematika e konstatuar për pasuritë e subjektit, përfshirë veprimet e kryera, deklarinet e pasinqerta, fakti që gjatë procesit të rivlerësimit ka arritur të mbledhë deklarata noteriale që u vlerësuan se nuk pasqyrojnë të vërtetën edhe nga shitësit e automjetit, vite pasi janë kryer veprimet dhe teorikisht në pozitat e publikut të gjerë, sikurse edhe mungesa e burimeve për krijimin e pasurive në vlerën prej 735.352 lekësh, duhet të ishte vlerësuar *minimalisht* si një ndër aspektet me peshë në vlerësimin e përgjithshëm të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

B. Për kriterin e vlerësimit profesional

6. Komisioni ka konstatuar problematika me natyrë të ndryshme në 10 çështje të marra në analizë, nga të cilat tetë (8) e kanë burimin nga denoncimet, një (1) nga të dhënat arkivore dhe një (1) nga çështjet e shortuara. Problemet e konstatuara grupohen kryesisht në (i) vonesa të konsiderueshme në regjistrimin e procedimit penal, (ii) zvarritje të procedimeve penale dhe zgjatjes së afateve pa

²⁵ Lidhur me një automjet të blerë në vitin 2009 për 530.000 lekë, të paregjistruar për dy vite, dhe shitur relativisht menjëherë pas regjistrimit, për 6.000 euro, më 02.12.2009. Pasqyruar në vendimin e Komisionit, në paragrafin 27 e nënpjesët e tij.

arsye të përligjura apo pa arsyetim, (iii) mungesa të përsëritura e të pajustificuara në 23 seanca gjyqësore, (iv) hetime të cekëta të cilat passjellin mosfillime, dhe në njërin prej rasteve të marra në analizë, (v) subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në dukje. Së fundmi, subjekti rezulton të këtë treguar mangësi në përmbushjen e përgjegjësive ndaj palëve për të ushtruar të drejtat e tyre, nëpërmjet mosmbikëqyrjes së zbatimit të detyrave të tij nga policia gjyqësore. Në vlerësimin e Komisionit, shpjegimet e subjektit në pjesën më të madhe *nuk* kanë përmbysur barrën e provës.

7. Votova ndryshe nga shumica pasi edhe në vlerësimin tim, problemet e konstatuara për këtë kriter, ishin të një natyre dhe sidomos vazhdimësie, që tregojnë për një qasje konstante të subjektit që përbën *zgjedhje* të tij e, si pasojë, nuk mund të argumentohen se korrigjohen nëpërmjet trajnimit të mëtejshëm. Në kushtet që subjektit i është dhënë një masë disiplinore në vitin 2014, “për shkak të zvarritjeve të theksuara dhe të pajustificuara të proceseve për shkaqe të papërligjura”, e cila rezulton të mos ketë passjellë asnjë efekt, si dhe nëse analizohen shpjegimet me natyrë justifikuese, shfajësuese e nëpërmjet të cilave subjekti shmang çdo përgjegjësi individuale për gjithë pyetjet e ngritura, e gjej të pabazuar kanalizimin e problemeve të konstatuara dhe qasjes minimizuese e shfajësuese të subjektit në proces, në problem që shërohet nëpërmjet trajnimit të mëtejshëm të një magjistrati me mbi 16 vjet karrierë.
8. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit ka treguar në mënyrë konstante një model sjelljeje e veprimesh të papranueshme me detyrën, sikurse edhe mungesë vullneti për reflektim. Në kushtet që nga 10 procedime të gjetura me problematika, gjashtë (6) i përkasin periudhës *pasi* subjekti ka marrë masën disiplinore më 01.10.2014 nga Prokuroria e Përgjithshme, çmoj se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, pasi ka dëshmuar një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit. Si pjesë të vlerësimit të përgjithshëm, të parashikuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, këto mangësi duhet të passillnin shkarkimin e subjektit nga detyra.
9. Konkluzioni i mësipërm mban në konsideratë sa është konstatuar gjatë hetimit administrativ në Komision. Pa përsëritur sa është trajtuar gjerësisht në vendimin objekt ankimi, problematikat kryesore të konstatuara në 10 çështjet për të cilat Komisioni ka konkluduar mangësi në punën e subjektit, janë të natyrës organizative, aftësisë për të ndërmarrë veprime e kryer hetime, qëndrime të gabuara, sikurse edhe sjellje të demonstruara nga subjekti, që dëshmojnë një mënyrë të vepruarit që cenon edhe të drejtat e palëve në proces. Konkretisht, në të paktën gjashtë (6) prej çështjeve të analizuara në vendim, subjekti ka regjistruar procedimet penale disa muaj pasi është dokumentuar kallëzimi, në shkelje të hapur të afatit 30-ditor të përcaktuar nga udhëzimi nr. 241/2005 i Prokurorit të Përgjithshëm, dhe 15-ditor të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Penale pas ndryshimeve të vitit 2017. Këto vonesa kanë variuar nga dy deri në 7 muaj. Përveç ngarkesës në punë, subjekti ka paraqitur shpjegime të pakuptimta, sipas të cilave zhvlerësohet fuqia detyruese e akteve nënligjore

të kohës – udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale – që ishte i detyrueshëm për prokurorët.

10. Është me rëndësi fakti i konstatuar nga hetimi administrativ për periudha kohore të konsiderueshme, gjatë të cilave subjekti nuk ka kryer veprime hetimore në shtatë (7) prej çështjeve. Këto intervale kanë variuar nga dy deri në 20 muaj. Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar për mënyrën e vlerësimit të periudhave kohore të tejzgjatura pa veprime procedurale nga prokurorët²⁶. Përpos sa më sipër, parë në aspektin e aftësive organizative dhe vëmendjes për respektimin e të drejtave të palëve, kryerjes së detyrës në përputhje me interesin publik dhe perceptimin e publikut për drejtësinë, e vlerësova të papranueshme sjelljen e subjektit përgjatë procesit penal që lidhej me {***}, regjistruar në vitin 2011 e në proces gjyqësor deri në vitin 2017²⁷. Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti ka munguar në 23 seanca gjyqësore në periudhën kohore 2014-2017, ndër të cilat, vetëm në njërin rast mungesa e tij ishte e përligjur dhe dokumentuar për shkaqet e pamundësisë. Ndër 22 seancat e tjera gjyqësore, në gjashtë (6) subjekti nuk ka dhënë *asnjë arsye* në *asnjë* formë, në 10 seanca ka njoftuar se ishte në seancë mase sigurie apo ekstradimi, pa përcjellë dokumentacion mbështetës, dhe gjashtë (6) të tjera, duke pretenduar arsye shëndetësore apo leje vjetore, po ashtu pa *asnjë* dokumentacion provues. Duke pasur parasysh që në këtë çështje gjykoheshin 15 të pandehur, e vlerësoj qasjen e subjektit në mospërputhje me përgjegjësitë që ka si magjistrat për të vepruar në interesin publik apo për të treguar sjellje që përçon respekt për sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e palëve, sikurse edhe për autoritetin e pushtetit gjyqësor.
11. Së fundmi, në të paktën dy nga çështjet e analizuara, subjekti ka zgjatur afatin e hetimeve pa asnjë arsyetim dhe pa specifikuar veprimet hetimore që duhet të ndërmerreshin, apo të cilat ishin kryer ndërkohë e që krijojnë nevojën e zgjatjes së mëtejshme të hetimit. Në tri çështje të tjera, subjekti ka rezultuar të ketë kryer hetime të cekëta, duke anashkaluar pretendime me rëndësi të kallëzueses, përfshirë pushimin e hetimit për shkaqe të pabazuara²⁸, sikurse edhe pa trajtuar memot e paraqitura nga kallëzuesi, sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale²⁹. Ndonëse veçmas këto problematika janë të pamjaftueshme për të passjellë një masë disiplinore, ato duhet të vlerësohen në mënyrë integrale me problemet e tjera dhe me sjelljen e demonstruar nga subjekti dhe shpjegimet e tij jobindëse.

²⁶ *Shih, ndër të tjerë, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit A. Dalipaj: https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/01/Vendim_Agim_Dalipaj_anonimizuar.pdf, si dhe subjektit B. Bejko: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/11/Vendim-i-anonimizuar-JR-Bledar-Bejko-s%C3%AB-bashku-me-mendimin-e-pakic%C3%ABs.pdf>.*

²⁷ *Hetuar nga Komisioni për shkak të dy denoncimeve nga z. B. K..*

²⁸ *Denoncimi i z. H. Sh.. Subjekti ka vendosur pushimin bazuar në ngjarjen e gabuar, duke pretenduar se ishte objekt i një procedimi tjetër.*

²⁹ “[...] 1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.”

12. Nga sa më sipër, subjekti paraqet një sjellje me mangësi të rëndësishme në respektimin e afateve procedurale, nën dritën e nenit 74, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016³⁰, si dhe aftësisë për të ndërmarrë vendime e kryer veprime si dhe arsyetuar ato, nën dritën e nenit 73, pikat 2 dhe 3³¹ të të njëjtit ligj. Çmoj se shpjegimet e subjektit në procesin e hetimit administrativ, edhe në lidhje me këtë kriter, sikurse tek ai i vlerësimit të pasurisë, janë jobindëse, përpos edhe evazive, në funksion të pasqyrimin të situatave faktike në shtrembërim të fakteve. I tillë ishte shpjegimi i dhënë prej subjektit për periudhat kohore pa veprime hetimore, që kanë rezultuar nga njëri prej denoncimeve³². Nga aktet në fashikull, ka rezultuar që kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare i përkiste një procedimi penal të ndryshëm nga ai për të cilin subjektit i ishte kërkuar të jepte shpjegime, por edhe që nuk kishte vend sekreti hetimor si shkak për të mos dhënë shpjegime, pasi procedimi në fjalë ishte mbyllur. Në të njëjtën mënyrë e vlerësova edhe shpjegimin e subjektit për veprën penale të dhunës në familje, sipas një prej denoncimeve, për të cilën subjekti shfaqëson vonesën tremujore në regjistrimin e kryer pa emër, me faktin që bashkëshortja kallëzuese *nuk ka kërkuar* ndjekje penale, ndonëse vepra ndiqet *kryesisht* dhe kallëzuesja kishte kërkuar edhe urdhër mbrojtjeje³³.
13. Komisioni ka konstatuar se në njëërën nga çështjet, analizuar si rrjedhojë e një denoncimi, subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit në dukje të interesit. Vlerësoj se ky konkluzion ishte i drejtë dhe duhet të ishte marrë në konsideratë në vlerësimin profesional së bashku me mangësitë e shtjelluara më sipër. Ndonëse e pamjaftueshme veçmas për një masë disiplinore, porë në vlerësimin e përgjithshëm, sjellja e subjektit në çështjen penale me objekt 15 punonjësit e {***}, duhet të ishte vlerësuar si një ndër shumë aspektet që në panoramë të gjerë, tregojnë sjellje të subjektit që cenon haptazi besimin e publikut të drejtësisë. Konkretisht, ndonëse ka rezultuar se lidhja gjinore e subjektit me njërin prej drejtuesve të të pandehurve ishte e largët, në kushtet e kërkesave të përsëritura të të pandehurve për përjashtimin e tij, subjekti duhet të kishte ndërmarrë hapa për të kërkuar përjashtimin e tij. Duke mbajtur në konsideratë edhe mungesat e shumta dhe të përsëritura në këtë proces [analizuar më sipër], zgjedhja e subjektit për të mos kërkuar dorëheqjen, dëshmon

³⁰ Neni 74 parashikon: “[...] 4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale, brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. 5. Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes”.

³¹ Neni 73 parashikon: “[...] 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si: qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit”.

³² Pasqyruar e analizuar në vendimin e Komisionit, në paragrafin 104 e nënpjesët e tij.

³³ Arsyetuar në vendimin e Komisionit, paragrafi 99 e nënpjesët e tij.

për një sjellje minimalisht mospërfillëse haptazi dhe të përsëritur ndaj procesit gjyqësor në tërësi. Këto të dhëna, analizuar në vlerësimin e përgjithshëm të përshtatshmërisë së subjektit për të vijuar detyrën, nën dritën e nenit 75, pikat 1 e 4 të ligjit nr. 96/2016, dëshmojnë pamundësi për korrigjim nëpërmjet trajnimit.

14. Në përmbledhje të sa më sipër, për të dy kriteret e rivlerësimit, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e pasinqerta, jobindëse, sikurse edhe të pakuptimta të subjektit, evidentuar më sipër dhe në vendimin e Komisionit, ndryshe nga shumica, votova për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit që shkarkoi nga detyra subjektin e rivlerësimit Julian Xhengo.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi